




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

BULETIN STATISTIKOR

QARKU GJIROKASTËR

VITI 2018



<i>Përmbajtja</i>	<i>fq</i>
-------------------	-----------

1. <i>Parathënie : Fjala e Prefektit të qarkut Gjirokastrë</i>	3
2. <i>Hyrje</i>	4

KAPITULLI I - Të dhëna të përgjithshme

• <i>Qarku Gjirokastrë</i>	7
• <i>Harta e qarkut Gjirokastrë</i>	8
1.1. <i>Kufizimet</i>	9
1.2. <i>Pozita gjeografike</i>	9
1.3. <i>Kushtet klimaterike</i>	9
1.4. <i>Struktura Administrative</i>	10
1.5. <i>Popullsia</i>	11
1.6. <i>Demografia</i>	12
1.7. <i>Rrjeti Rrugor</i>	12
1.8. <i>Pikat doganore</i>	15
1.9. <i>Biodiversiteti dhe Ekosistemi</i>	16
- <i>Flora dhe Fauna</i>	
- <i>Burime ujore</i>	
- <i>Lugina</i>	
1.10. <i>Burimet turistike</i>	18
1.11. <i>Kultura</i>	23
1.12. <i>Besimi fetar</i>	24

KAPITULLI II - Të dhëna të përgjithshme; Bashkitë e qarkut Gjirokastrë

2.1 <i>Bashkia Gjirokastrë</i>	26
2.2 <i>Bashkia Tepelenë</i>	27
2.3 <i>Bashkia Përmet</i>	28
2.4 <i>Bashkia Këlcyrë</i>	29
2.5 <i>Bashkia Dropull</i>	30
2.6 <i>Bashkia Libohovë</i>	31
2.7 <i>Bashkia Memaliaj</i>	32

KAPITULLI III - Monitorimi dhe zbatimi i politikave të Këshillit të Ministrave në qark

3.1 <i>Arsimi</i>	34
3.2 <i>Shëndetësia</i>	36
3.3 <i>Turizmi</i>	37
3.4 <i>Mjedisi</i>	41
3.5 <i>Ekonomia</i>	42
3.6 <i>Bujqësia</i>	44
3.7 <i>Blektoria</i>	47
3.8 <i>Punësimi</i>	49
3.9 <i>Ndihma ekonomike</i>	50
3.10 <i>Siguria dhe rendi public</i>	51
3.11 <i>Emergjencat civile</i>	52
3.12 <i>Monitorimi i fondeve të transferuara nga buxheti për njësitë e vetëqeverisjes vendore</i>	52
3.13 <i>Zhvillimi Rajonal</i>	53
3.14 <i>Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore</i>	64
3.15 <i>Programi kombëtar për zhvillimin rural – “100 fshatrat”</i>	65
3.16 <i>Roli i Institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë në zhvillimin e rajonit</i>	67

Parathënie

Fjala e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë

Zhvillimi rajonal mbetet një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare, politikat e së cilës koordinohen duke synuar zhvillim ekonomik dhe jetë sociale të përmirësuar. Kohët e fundit vendi ynë ka pësuar një proces të thellë dhe të përsheptuar të ndryshimeve ekonomike, sociale dhe territoriale. Edhe gjatë vitit 2018, u ndërmorën një sërë reformash strukturore, të nevojshme për arritjen e objektivave për integrim rajonal. Disa reforma duan kohë të materializohen dhe të japin efektet positive, e megjithatë, duket qartë që mundësitë për zhvillim në qarkun Gjirokastrë janë të mëdha si pasojë edhe e përcaktimit të objektivave kryesore dhe krijimit të besimit ndaj publikut duke i informuar vazhdimisht mbi qëllimin kryesor të tyre.

E parë në kontekstin e zhvillimeve që kanë ndodhur në rajon, është e nevojshme dhe detyrë prioritare e qytetarëve të saj që me përgjegjësi maksimale të rimëkëmbin dhe mbrojtur ato vlera materiale dhe njerëzore që ky qark mbart në gjithë historinë e krijimit të tij.

Vendndodhja e favorshme gjeografike, bukuritë natyrore dhe potencialet turistike e historike, të orientuara këto dhe nga rezultatet e politikbërjes, ka bërë që në qarkun Gjirokastrë ato të zbatohen dhe të japin rezultatet afatgjata.

Nisur nga interesi i përgjithshëm për zhvillimin e rajonit tonë, institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë hartoi këtë material gjithëpërfshirës ku harmonizohen prioritetet dhe objektivat kryesore për zhvillim dhe ndryshim.

Duke qenë se *Misioni i Prefektit të qarkut është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave*, qëllimi kryesor i këtij materiali është njohja me qarkun Gjirokastrë, bashkërendimi i politikave të Qeverisë Shqiptare, monitorimi dhe vlerësimi i progresit të bërë në sektorë kyç, për vitin 2018.

Shpreh vlerësimin më të lartë për përfundimin e tij dhe shpresoj që ky botim do të shërbejë si ndihmë për çdokënd që është i interesuar të njohë qarkun e Gjirokastrës. Në vitet në vazhdim ky material do të përditësohet dhe përmirësohet për të ndihmuar këdo që punon dhe synon të kontribuojë sadopak në zhvillimin e qarkut tonë. Nuk mund të lë pa falënderuar stafin e institucionit të Prefektit të qarkut, stafin e institucioneve rajonale, përfaqësuesit e pushtetit vendor, përfaqësues të shoqërisë civile dhe gazetarë, për angazhimin e tyre në hartimin e këtij materiali.

Në çdo gjë që ndryshon ka vend për përmirësim. Duhet akoma shumë punë për të bërë të mundur zhvillimin, emancipimin, dhe stabilitetin që qarku ynë meriton.

“Sfida për një zhvillim rajonal të qëndrueshëm, është një përpjekje e përbashkët dhe e vazhdueshme”

Me respekt
Prefekti i Qarkut Gjirokastrë
ASTRIT ALIAJ

Janar 2019

Hyrje

Si pjesë e procesit të zbatimit të reformave dhe përmbushjeve të detyrimeve ligjore, stafi i institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë, hartoi materialin informues “Buletini Statistikor i qarkut Gjirokastrë për vitin 2018” i cili synon mbi të gjitha të paraqesë ecurinë dhe rezultatet e politikave të qeverisë shqiptare për vitin 2018.

Ky material është përpunuar nga stafi i Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara pranë Institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë. Për hartimin e tij, jemi bazuar në burime institucionale por dhe raporte të institucioneve qëndrore për të ofruar një situatë aktuale socio-ekonomike të rajonit, duke hedhur një vështrim të përgjithshëm në treguesit më të rëndësishëm statistikor. Këto të dhëna janë përpunuar dhe analizuar kryesisht nga pikëpamja dhe rezultatet e politikave qëndrore. Duke qenë botimi i parë, jemi të vetëdijshëm se ka nevojë për përmirësim. Në vazhdim do të punohet për saktësimin e të dhënave statistikore dhe përcaktimin e objektivave bazë me qëllim harmonizimin e tyre me politikat qëndrore. Si pasojë e mungesës së informacionit të përgjithshëm statistikor dhe informues në nivel institucional, institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë fton të gjithë aktorët kryesor në institucionet shtetërore rajonale, njësi vendore, shoqëri civile, OJF, përfaqësues të bizneseve, gazetarë etj, të kontribuojnë sadopak me botime statistikore informuese në funksion të zhvillimit rajonal,

me qëllim identifikimin dhe përballimin e sfidave për një të ardhme më të mirë për të gjithë.

Burimi i informacionit:

1. INSTAT, Vjetari Statistikor Rajonal 2017
2. Strategji të ndryshme të Zhvillimit Rajonal
3. Strategjia e Arsimit për të gjithë qarku Gjirokastrë 2008-2018
4. Planet e përgjithshme vendor të qarkut Gjirokastrë
5. Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut
6. Drejtoria e Përgjithshme e gjendjes civile, viti 2018
7. Drejtoria e Rajonit Rrugor, Jugor Gjirokastrë
8. Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit
9. Drejtoria Rajonale Arsimore, Gjirokastrë
10. Zyra Rajonale e Punës Gjirokastrë
11. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Gjirokastrë
12. Sektori i bujqësisë dhe sektori i veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve, Gjirokastrë
13. Sektori i Policisë Pyjore të Degës Rajonale të ISHMPUT-së
14. Evidenca statistikore të njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2018
15. Buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2018
16. “Trembëdhjetë petalet e para në buqetën rurale”. Botim special i institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë për zhvillimin rural të 13 fshatrave turistik të qarkut Gjirokastrë, viti 2018
17. Ligji nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”
18. VKM nr. 915, datë 11.11.2015 “Për transferimin në pronësi, nga këshillat e qarqeve të bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve”
19. Ligji nr. 115/2015 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”

Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë

Në veprimtarinë e tij të përgjatë 2018, institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë ka funksionuar në përputhje me ligjin nr. 107/2016 *”Për Prefektin e qarkut”*, me aktet ligjore dhe nënligjore të Këshillit të Ministrave, të Ministrisë së Brendshme dhe të ministrive të linjës në drejtim të garantimit dhe zbatimit të programit të Këshillit të Ministrave në nivel qarku.

Prioriteteti kryesor i punës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, për vitin 2018, ka qenë ngritja në një shkallë më të lartë e frymës së bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit të organeve të qeverisjes vendore, degëve territoriale që veprojnë në qark dhe institucione të tjera. Gjithashtu, puna është përqëndruar në

drejtimin e strukturave për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile, drejtimin e task forcave, si dhe kontrollin dhe monitorimin e zbatimit në nivel qarku të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm, kulturë etj

Zbatimi i objektivave të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 *”Për Prefektin e qarkut”*, të ndërlidhura më interesat e rajonit, mbeten përgjegjësitë kryesore ligjore dhe morale të Prefektit të qarkut Gjirokastrë dhe administratës që ai drejton, për periudhën në vazhdim.

KAPITULLI I

Të dhëna të përgjithshme
Qarku Gjirokastrë
Viti 2018

QARKU GJIROKASTËR

Qarku Gjirokastrë është një nga 12 qarqet në Shqipëri dhe ka një sipërfaqje prej 2.884 km², afërsisht 10% e territorit të vendit. Shtrihet në krahinën malore jugore, pozita e së cilës është e përshtatshme për zhvillimin ekonomik, me klimë mesdhetare, toka prodhuese dhe bimësi të zhvilluar. Rajoni përbëhet nga zona paramalore mesdhetare jugore Qarishtë – Dangëlli – Çarshovë, zona mesdhetare malore jugore Dhëmbel – Nemëçkë, Lunxhëri – Bureto dhe Mali i Gjerë – Stugarë. Qarku Gjirokastrë është pozicionuar në qendër të Shqipërisë Jugore dhe përshkrohet nga dy prej luginave më të rëndësishme në Shqipërinë Jugore, Lugina e Vjosës së Sipërme dhe Lugina e lumit Drino. Në këto lugina është përqëndruar pjesa më e madhe e popullsisë së qarkut dhe në të njëjtën kohë ato përbëjnë edhe pjesët kryesore të zhvillimit ekonomik dhe industrial të rajonit.

Qarku i Gjirokastrës ka si qendër administrative qytetin e Gjirokastrës, një qytet mesjetar që daton si vendbanim i konsoliduar që prej shekullit të XIII, me ndërtesa tipike të arkitekturës orientale të përzier me elementët vendas. Për veçantinë e arkitekturës dhe vlerave të saj të rralla mesjetare, Gjirokastra u klasifikuan nga ICOMOS si pasuri me vlera botërore dhe unike, e më pas UNESCO në mbledhjen e Pekinit në vitin 2005, e listoi si kërkesë dhe e aprovoi duke e bërë pjesë të Trashëgimisë Kulturore Botërore. Baza e ekonomisë është blektoria dhe bujqësia, por në rajon po rritet dhe industria e përpunimit të ushqimit, duke

shfrytëzuar mundësinë që jep prodhimi i frutave, perimeve dhe nënprodukteve blegtorale. Aktivitete kryesore ekonomike në rajonin e Gjirokastrës janë tregëtia, industria e nxjerrjes dhe përpunimit të gurit për ndërtim dhe atij dekorativ, industria e ambalazhimit të ujit dhe pijeve freskuese si Glina, Uji i Ftohtë Tepelenë, Uji Trebeshina, Uji Çajupi, Fresh Compani ELKA etj, fabrikat e përpunimit të qumështit dhe prodhimit të djathrave dhe nënprodukteve të qumështit si Gjirofarma dhe Libohova, industria e tregëtimit dhe përpunimit të drurit, industria e prodhimit të inerteve dhe ndërtimit, repartet e shumta të prodhimit të veshjeve dhe këpucëve për tregjet e huaja etj. Vitet e fundit turizmi po tregon se është një nga shpresat më të mëdha për zhvillimin ekonomik të qarkut bazuar kjo dhe në trashëgiminë unike kulturore, historike dhe arkitekturore. Në Luginën e Drinos gjenden disa site arkeologjike ku më të rëndësishmit janë "Antigonea", rreth 14 km nga Gjirokastra dhe siti romak i Hadrianopolit shek.II ps.k. në afërsi të fshatit Sofratikë. Mbresëlënëse dhe me vlera historike e arkitektonike janë edhe kishat paleokristiane të Shën Marisë në Labovë dhe Peshkëpi. Me shumë vlera janë Parqet natyrore si ai i Viroit, Sotirës, Ujit të Ftohtë Tepelenë, Hotovës, Pllaja e Çajupit (1200 m), Ujrat Termale të Bënjës (Përmet) si dhe kanionet e Lumit të Suhës, Zagorisë, Vjosës dhe Nivicës.



Harta e qarkut Gjirokastrë,
(bazuar në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”)

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Sipërfaqja: 2.884 km².

Popullsia: 152. 043 banorë.

Dendësia: 50 banorë/km².

1.1 KUFIZIMET:

- Në veri me qarkun e Beratit
- Në veriperëndim me qarkun e Fierit
- Në jug deri në perëndim me qarkun e Vlorës
- Në juglindje me Greqinë
- Në lindje me qarkun e Korçës

1.2 POZITA GJEOGRAFIKE:

- Gjerësia gjeografike – veri 40° 32' – jug 39° 47'
- Gjatësia gjeografike – lindje 20° 37' - perëndim 19° 45'

Shtrihet në një lartësi mesatare 829 m mbi nivelin e detit.

Zonat më të larta janë:

- Mali i Gjerë 1887 m
- Bureto – Lunxhëri 2155 m
- Dhëmbeli 2080 m e Nemëçka ku maja më e lartë është Drita 2458 m.

Përgjithësisht në rajonin e Gjirokastrës ndeshen territore të larta dhe të pjerrëta me versione të ndryshme të ekosistemit i cili ndryshon papritur thyerjet, kontrastet nga drejtimi vertikal në atë horizontal. Ndeshen disa lloj ekosistemesh si: ekosistemi i lumit, kodrës dhe ai alpin. Këto ekosisteme ndeshen në Grykën e Këlcyrës dhe në Grykën e Bënçës.

1.3 KUSHTET KLIMATERIKE

- Klimë mesdhetare kodrinore malore
- Temperature mesatare në janar: – 5°c
- Temperature mesatare në korrik: ~24°c
- Rreshjet mestare vjetore: ~ 1858 mm shi

1.4 STRUKTURA ADMINISTRATIVE**QARKU GJIROKASTËR**

7 BASHKI

6 QYTETE

32 NJËSI ADMINISTRATIVE

271 FSHATRA

a. Ndarja administrative-territoriale

	Qendra e bashkisë	Qytet	Njësi administrative	Fshatra
Bashkia Gjirokastrë	Qyteti Gjirokastrë	1	7	38
Bashkia Libohovë	Qyteti Libohovë	1	3	17
Bashkia Dropull	Fshati Jorgucat		3	41
Bashkia Tepelenë	Qyteti Tepelenë	1	4	24
Bashkia Memaliaj	Qyteti Memaliaj	1	6	53
Bashkia Përmet	Qyteti Përmet	1	5	49
Bashkia Këlcyrë	Qyteti Këlcyrë	1	4	48
Totali		6	32	271

(bazuar në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”)

b. Sipërfaqja e bashkive të qarkut Gjirokastrë

Nr	Bashkia	Sipërfaqe (km2)
1	Gjirokastrë	469.2
2	Libohovë	248.2
3	Dropull	448.2
4	Përmet	601.9
5	Këlcyrë	304.6
6	Tepelenë	431.2
7	Memaliaj	372

1.5 POPULLSIA

a. numri i popullsisë së qarkut Gjirokastrë

Qarku	Bashkia	Njësia administrative	Nr. popullsisë	Totali
GJIROKASTËR	GJIROKASTËR	Gjirokastrë	33.658	52.016
		Cepo	6.267	
		Picar		
		Lazarat	3.450	
		Lunxhëri		
		Antigone	8.641	
		Odrie		
	LIBOHOVË	Libohovë		6.970
		Qendër Libohovë	6.970	
		Zagorie		
	DROPULL	Dr. i Poshtëm	9.369	22.754
		Dr. i Sipërm	10.323	
		Pogon	3.062	
	PËRMET	Përmet	9.731	18.988
		Çarçovë	2.872	
		Petran	3.051	
		Piskovë	3.334	
		Frashër		
	KËLCYRË	Këlcyrë	5.072	12.148
		Ballaban	2.014	
		Dishnicë	2.474	
		Sukë	2.588	
	TEPELENË	Tepelenë	7.731	15.961
		Q.Tepelenë		
		Lopës	8.230	
		Kurvelesh		
	MEMALIAJ	Memaliaj	6.354	20.136
		Fshat Memaliaj	2.647	
		Krahës		
		Qesarat	6.377	
		Luftinjë	4.758	
		Buz		
TOTALI I QARKUT		149.473 Shtetas		

(Burimi i informacionit: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, viti 2018)

1.6 DEMOGRAFIA

Qarku i Gjirokastrës rregjistron rënien më të lartë të popullsisë gjatë viteve 2015-2018, prej 2,7 % ose 2 mijë banorë çdo vit duke e renditur atë si qarku më i vogël në Shqipëri për nga popullsia. Në vitin 2017 ai zinte 2.2% të popullsisë së përgjithshme të vendit. Ritmet e rënies së popullsisë së qarkut Gjirokastrë vlerësohen si ritmet më të larta në vend, krahasuar jo vetëm me mesataren kombëtare por edhe me ritmet e ndryshimit të popullsisë së qarqeve të tjera.

Përsa i përket minoriteti grek që jeton në qarkun e Gjirokastrës paraqiten këto të dhëna:

- Dropulli i Sipërm rreth 10 572 banorë
- Dropulli i Poshtëm rreth 9745 banorë
- Komuna Pogon rreth 3445 banorë
- Fshati Vllaho Psilloterë dhe Biovizhdë rreth 158 banorë

Minoritet ka dhe në qytetet Gjirokastrë, Tepelenë dhe Përmet.


1.7 RRJETI RRUGOR

Rrjeti i rrugëve në qarkun e Gjirokastrës është pothuajse 481 kilometra i gjatë, nga të cilat;

- rreth 280 kilometra janë rrugë nacionale
- rreth 201 km janë rrugë rurale.

Aksi kryesor rrugor është rruga nacionale SH4;

- Krahës-Tepelenë-Gjirokastrë- Kakavie, me gjatësi rreth 90 km.



a. Rrjeti i rrugëve nacionale të qarkut Gjirokastrë

Nr.	Akset rrugore	Firmat kontraktore	Gjatësia km
Gjirokastrë			65 km
1	Gjirokastrë - Kakavijë	SALILLARI.shpk	32
2	Jorgucat- Qafa e Muzinës	SALILLARI.shpk	9
3	Kthesa Dhuvjan - Libohovë	SALILLARI.shpk	10
4	Subash- Virua	SALILLARI.shpk	14
Tepelenë			126 km
1	Kufi Mallakastër deri në kufi Gjirokastrë	SALILLARI.shpk	58
2	Ura e Leklit deri në kufi të Përmetit	ERAL.shpk	12
3	Qafa e Kiçokut deri në Qafë Gllavë		21
4	Telepene deri në kufi të Vlorës	ERAL.shpk	35

Përmet			89 km
1	Përmet deri në kufi të Tepelenës	RIVIERA.shpk	25
2	Përmet deri në kufi të Leskovikut	RIVIERA.shpk	33
3	Kolonjë deri në Ballaban deri në kufi të Tepelenës		21
4	Carçovë deri te Tre Urat	RIVIERA.shpk	10
TOTALI			280 km

(tab nr.1 paraqet rrugët nacionale të qarkut Gjirokastrë dhe firmat kontraktore private për mirëmbajtjen e tyre, viti 2018)

b. Rrjeti i rrugëve rurale (në varësi të bashkive respektive)

Nr.	Aksi rrugor	Gjatësia /km
I.	Bashkia Gjirokastrë	35
1	Gjirokastrë - Antigone	18
2	Votuc - Picar	6
3	Humelicë – Andon Poçi	2
4	Gjirokastrë – Shën Todër	5
5	Ura e Kardhiqit - Cepo	1
6	Rruga Nacionale – Qendër Lazarat	3
II.	Bashkia Libohovë	29
1	Kthesa e Labovës - Selckë	15
2	Poliçan - Nivan	14
III.	Bashkia Dropull	23
1	Selckë - Poliçan	7
2	Poliçan - Sheper	3
3	Poliçan - Sopik	12
4	Rrugë Nacionale – fshat Dropull	1
IV	Bashkia Tepelenë	28
1	Tepelenë - Gusmar	28
V	Bashkia Përmet	31
1	Piskovë Frashër	31
VI	Bashkia Këlcyre	35
1	Këlcyre – Fshati Ballaban	15
2	Fshati Ballaban – Qafa e Këçokut	20
VII	Bashkia Memaliaj	20
1	Kthesë e Luftinjës - Buz	20
Totali i qarkut		201 km

(tab.nr 2 paraqet rrjetin e rrugëve rurale që administrohen nga bashkitë e qarkut Gjirokastrë, miratuar me VKM nr. 915, datë 11.11.2015)

a. Inventari i urave si element i rrugës automobilistike

Nr.	Emërtimi i urës	Aksi rrugor ku ndodhet	Gjatësia (m)	Lloji i urës
1.	Ura e Dervicianit	Gjirokaštër-Kakavi	30	Urë beton arme
2.	Ura e Goranxisë	Gjirokaštër-Kakavi	30	Urë beton arme
3.	Ura e Haskovës	Gjirokaštër-Kakavi	30	Urë beton arme
4.	Ura e Sofratikës	Gjirokaštër-Kakavi	30	Urë beton arme
5.	Ura e Goricës	Gjirokaštër-Kakavi	30	Urë beton arme
6.	Ura e Kseriasë	Gjirokaštër-Kakavi	89	Urë beton arme
7.	Ura e Kardhiqit	Gjirokaštër-Tepelenë	285	Urë beton-arme+hark guri
8.	Ura e Bënçës	Tepelenë-Kufi Mallakastër	67	Urë beton arme
9.	Ura e Memaliajt	Tepelenë-Kufi Mallakastër	136	Urë beton arme
10.	Ura e Luftinjës	Tepelenë-Kufi Mallakastër	145	Urë beton arme
11.	Ura e Dhuvjanit	K/Dhuvjan-Libohovë	29	Beton arme(b/a)+mur guri
12.	Ura e Xhait	K/Dhuvjan-Libohovë	26	Urë beton arme
13.	Ura mbi kanal nr.1	K/Dhuvjan-Libohovë	23	Urë beton arme
14.	Ura mbi kanal nr.2	K/Dhuvjan-Libohovë	20	Urë beton arme
15.	Ura e Shëntodhrit	Valare - Erind	55	Beton arme+mur guri
16.	Ura Bënçës	Tepelenë-Dorrëz	52.5	Urë beton +b/a
17.	Ura e Sinanajt	Tepelenë-Dorrëz	40	Urë beton arme
18.	Ura e Leklit	Ura e Leklit-Këlcyrë	80	Urë metalike
19.	Ura e Dragotit	Ura e Leklit-Këlcyrë	108	Urë metalike
20.	Ura e Mezghoranit	Ura e Leklit-Këlcyrë	25	Urë beton arme
21.	Ura e Këlcyrës	Këlcyrë-Përmet	54	Beton arme+mur guri
22.	Ura e Pagrisë	Këlcyrë-Përmet	110	Beton arme+mur guri
23.	Ura e Petranit	Përmet-Çarshovë	76	Urë beton arme
24.	Ura e Kaludhit	Përmet- Çarshovë	50	Urë beton arme
25.	Ura e Stojanit nr.1	Përmet-Çarshovë	24	Urë beton arme
26.	Ura e Stojanit nr.2	Përmet-Çarshovë	36	Urë beton arme
27.	Ura e Çarshovës	Përmet-Çarshovë	41	Beton arme+mur guri

(tab. nr.3 paraqet inventarin e urave të qarkut Gjirokaštër, bazuar në informacionet e marra nga Drejtoria e Rajonit Rrugor, Jugor Gjirokaštër)



Ura e Dragotit



Ura e Dervicianit

1.8 PIKAT DOGANORE

Qarku i Gjirokastrës i cili për Shqipërinë mund të quhet një nga portat e lidhjes me Europën komunikon me shtetin Grek, anëtar i Komunitetit European, nëpërmjet tre pikave doganore:

- Kakavie (Gjirokastrër)
- Tri Urat (njësia administrative Çarshovë, Përmet)
- Sopik (njësia administrative Pogon, Drimadhes)

a. Të dhëna statistikore për vitin 2018

Nr.	Hyrje/Dalje	Udhëtarë	Automjete
1	Hyrje shtetas shqiptarë	933,007	190,886
2	Dalje shtetas shqiptare	746,228	225,733
3	Hyrje shtetas të huaj	216,713	76,347
4	Dalje shtetas të huaj	206,075	75,874
Totali		2,102,023	568,840

(Burimi i informacionit: Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit)



pika doganore; Kakavie



policia kufitare; Sopik



pika doganore; Tri urat

1.9 BIODIVERSITETI DHE EKOSISTEMI

• FLORA DHE FAUNA

Qarku Gjirokastrë, falë larmishmërisë së relievit, e cila karakterizohet nga ndërprerja e ultësirës perëndimore me atë të zonës malore kontinentale, krijon habitate të paçmueshme. Formacionet gjeologjike, larmia e peizazheve, ujrat nëntokësor dhe sipërfaqësor, kushtet klimatike, kanë kondicionuar një shumëllojshmëri të pasur biologjike me vlera turistike, shkencore, e kulturore. Vitet e fundit, ky fond i pasur natyror i është nënshtruar një presioni të rritur të aktivitetit njerëzor kryesisht në afërsi të zonave urbane e rurale, duke e tjetërsuar në mënyrë të konsiderueshme këtë trashëgimi natyrore.

Flora: Pyjet dhe kullotat, të kombinuara së bashku mbulojnë rreth 64% të tokës në qarkun e Gjirokastrës. Ato strehojnë një shumëllojshmëri të faunës, si lepuj, ujë, derra dhe zogj. Kullotat janë të paçmueshme si një burim ushqimor për blegtorinë dhe gjithashtu për rreth 120 llojet e bimëve medicinale të qarkut. Shumica e zonës pyjore gjendet në zonën e Përmetit, që përmban edhe pjesën më të madhe të pyjeve malorë.



Frashëri i bardhë

Fauna: Varietetet e faunës në qarkun Gjirokastrë janë po aq të shumta sa edhe ekzotike. Pothuajse gjysma e gjitarëve mund të gjenden në rajon (31 nga 65), si dhe një numër i llojeve të lakuriqëve të natës që strehohen në shpella. Për sa i përket zogjve, 93 nga 320 specje që ka vendi, banojnë në qark. Lugina e lumit Drinos dhe lumi i Vjosës veprojnë si rrugë e rëndësishme migrimi. Ky qark strehon gjithashtu 18 nga 37 specjet e zvarranikëve të Shqipërisë, dhe 10 nga 15 specje të amfibëve të vendit. Përsa i përket 60 specjeve të peshkut të ujërave të ëmbla, qarku numëron rreth 11 specje nga të cilat 5 po humbasin.

Ndër popullatat me të stabilizuara janë të dhelprës, ujkut evropian, çakallit, nuselalës, lepurit, iriqit si dhe një sërë specjesh zogjsh përfshi turtulli, gardalina, mëllenja, qukapiku i drurit, qyqja, gushëkuqi etj.

Në zonën e Gjirokastrës shitegëton Kali i qyqes i cili është vlerësuar nga specialistët si një specie në zhdukje. Në Gjirokastrë janë identifikuar 4 çifte të kalit të qyqes, që kërkojnë kujdes të veçantë ndërsa në rang vendi janë identifikuar 10 çifte. Specialistët thonë se kali i qyqes është i rrezikuar nga helmimet që barinjtë bëjnë nëpër male për ujëqerit, kryesisht me kërmë të ndryshme por pa dashje ata helmojnë edhe kalin e qyqes. Ky shpend ka funksion ekologjik por është edhe një aset për zhvillimin e turizmit natyror.



Kali i Qyqes

• BURIMET UJORE

Kapaciteti uhor për ujitjen e tokave bujqësore.

Në qarkun e Gjirokastrës janë ndërtuar gjithësej 71 rezervuarë (ujëmbledhës), ujitës me një kapaciteti total prej 43.3 milion m³ ujë:

- Rrethi Gjirokastrë: 31 rezervuarë me kapacitet 29.3 milion m³ ujë.

- Rrethi Përmet: 24 rezervuarë me kapacitet 6.9 milion m³ ujë.
- Rrethi Tepelenë: 16 rezervuarë me kapacitet 7.1 milion m³ ujë.

Rezervuari më i madhi ndërtuar në qarkun e Gjirokastrës është ai i Doftisë (i Bulos) me një kapacitet prej 16.6 milion m³ ujë dhe aftësi ujitëse të projektuar 4500 ha i cili shërben për ujitjen e tokave bujqësore të fushës-Dropull-Gjirokastrë.

• LUGINAT

Lugina e Vjosës

Është një nga lumenjtë më të mëdhenj të Shqipërisë Jugore, sidomos përse i përket prurjeve vjetore. Degët kryesore të Vjosës janë Sarandoporo, Drino dhe Shushica. Në këto degë të lumit Vjosa përfundojnë dhe shumë burime karstike, si ato të grykës së Këlcyrës, Libohovës, Viroit të Gjirokastrës, Ujit të Ftohtë të Tepelenës, Poçemit etj.

Vjosa buron nga malet e Pindit në Greqi, ku rrjedh nëpër një luginë të thellë, e cila zgjerohet pasi hyn në territorin tonë.

Nga Këlcyra në Dragot Vjosa përshkon grykën madhështore të Këlcyrës. Sipërfaqja e përgjithshme e pellgut ujëmbledhës të lumit Vjosa është 6,706 km². Nga kjo sipërfaqe 4,365 km² shtrihen brenda territorit të kufijve shtetëror të Shqipërisë,

pjesa tjetër e sipërfaqes së pellgut të këtij lumi shtrihet në Greqi. Lugina e Vjosës në zonën e Përmetit, Tepelenës, Memaliajt, Salenicës dhe rrethinave të Vlorës është nga më të populluarat në vend dhe përbën në të njëjtën kohë një bazë të fuqishme për zhvillimin e bujqësisë.



pamje nga lugina e Vjosës

Lugina e Drinosit

Lumi Drino është dega më e madhe e rrjetit hidrografik të lumit Vjosa. Në pellgun ujëmbledhës të lumit Drino lartësitë dominuese janë ato 200-1,000 m mbi nivelin e detit që vënë në dukje natyrën malore të pellgut ujëmbledhës të këtij lumi. Lumi Drino e ka fillimin e tij në Greqi, në shpatet perëndimore të malit të Elatos. Futet në Shqipëri midis Radatit dhe Kakavies dhe ndjek rrjedhën Veri-Perëndimore pa dredhime nëpër një luginë relativisht të rregullt. Kalon nëpër ultësirën që shtrihet mes strukturave të Malit të Gjerë - Shtugarë dhe Lunxhëri - Bureto. Lumi Drino ka ndërtim specifik të pellgut të tij ujëmbledhës, ku shkëmbinjtë karstikë mbulojnë pjesën më të madhe të territorit. Ato ndërtojnë shpatet lindore të Malit të Gjerë, pjesën Jug-Lindore të pllajës së Kurveleshit, si dhe një pjesë të madhe të Lunxhëri-Buretos.

Burimi i fuqishëm “Syri i Kaltër” i Bistricës ushqehet nga ujërat që drenohen nga shpati


lindor i Malit të Gjerë si dhe nga pjesa e shtratit të lumit Drino që shtrihet nga Vriseraja deri në Gjirokastrë. Burime karstike janë dhe ato të Nepravishtës, Libohovës, Hormovës, Picarit, burimi i përkohshëm i Viroit të Gjirokastrës etj, të cilët ndodhen brenda sipërfaqes së pellgut ujëmbledhës së lumit Drino. Për mbrojtjen e tokave bujqësore janë ndërtuar gjithësej 88 km argjinatura mbrojtëse nga lumenjtë Drino, Suhë e Kseria në fushën e Dropullit, Gjirokastrë.



pamje nga lugina e Drinos

1.10 BURIMET TURISTIKE


Qarku i Gjirokastrës, në sajë të burimeve turistike që ka, është cilësuar si qarku me pasuritë më të mëdha të rajonit, dhe jo pak por 697 burime turistike, që nënkuptojnë pika kulturore, objekte historike e arkeologjike, monumente të natyrës si shpella, kanione, objekte kulti, ndërtime popullore etj, 30 prej të cilave janë etiketuar zonë e mbrojtur.




Resurset Natyrore

Bashkia Gjirokastrë

1. Viroi (mema e ujit) i Gjirokastrës
2. Kanioni i Piksit
3. Shembja e Zhulatit
4. Rrëshqitja e Kllezit
5. Rrëshqitja në malin e Karparielit
6. Qafa e Çajupit
7. Dalja e magmatikeve afër Picarit
8. Liqeni i Kacojthit
9. Rrapi i Zhulatit
10. Rrapi i Fushëbardhës
11. Rrapi i Mashkullorës
12. Rrapishte e Mashkullorës
13. Rrapi i Çerçizit –Gjirokastrë
14. Rrepet e Këllëzit
15. Rrapi i Dhoksatit
16. Rrapi i Tranoshishtës



pamje nga shpella nënujore e Viroit



pamje nga qafa e Çajupit

Bashkia Libohovë

1. Pylli i Gurtë – Nderan
2. Tarraca e Nderanit
3. Gurra e Nivanit
4. Burimi i Libohovës
5. Burimi i Nepravishtës
6. Shkëmbi i Zheit
7. Venjat e Konckës
8. Vithimat e Buretos
9. Vrimat e Konckës
10. Gështenja e Nepravishtës
11. Rrapi i Manastirit Stegopul
12. Rrapi i Libohovës
13. Rrapi i Ndëranit
14. Lisat e Skoresë
15. Lisat e Çorrokut – Sheper
16. Rrepet e shkollës – Sheper
17. Lisat e Manastirit – Nivan
18. Rrepet e Nivanit



Rrapi 550 vjeçar i Libohovës



Burimi i Nepravishtës

Bashkia Dropull

1. Shpella e Vanistrës
2. Burimi mineral i Glinës
3. Zhveshja e Muzinës
4. Rrepet e Selos
5. Rrepet e Mullirit në Selo
6. Përralli i Bodrishtës
7. Pishat e Kërres
8. Rrepet e Koshovicës
9. Selvitë e Kishës Hllomo
10. Rrepet e Çatistës
11. Lisat e Poliçanit
12. Selvitë e Hllomosë
13. Rrapi i Poliçanit

*pamje nga shpella e Vanistrës**Përrali i Bodrishtës****Bashkia Përmet***

1. Rapi i Megallarës- afër fshatit Gjinakar
2. Bredhi i Çarshovës së Vjetër
3. Pylli i Çukës
4. Pylli i Ropushës
5. Horizonte vithisëse dhe olistolite – Çarçovë
6. Perëndi e Borockës (Kanioni, Guri i Bletës)
7. Kanioni i Kamenikut
8. Ujëvara e Sopotit afër fshatit Stërbec
9. Ujrat Termale të Bënjës
10. Bredhi i Petranit
11. Selvia e Kishës – Leusë
12. Pusi i Nëmërçkës
13. Cirku i Nëmërçkës
14. Guri i Qytetit
15. Guri i Atos – afër fshatit Kutal
16. Kanioni i Lëngaricës
17. Bokërimat e Dangllisë
18. Gropa e Kazanit
19. Guri i Petranit
20. Grumbulli pyjor i Polmenit
21. Bredhi i Kokojkës Frashër
22. Arra e Llukanit-Frashër
23. Gështenja e Teqesë Frashër

*Ujrat Termale të Bënjës**Guri i qytetit, Përmet*

Bashkia Këlcyrë

1. Pylli i Gërhotit, afër fshatit Zhepë
2. Rrapi i Zhepës
3. Horizonte vithisëse dhe olistolite – Çarçovë
4. Shpella e Pëllumbave
5. Uji i Zi Këlcyrë
6. Rrepet e Grykës së Këlcyrës
7. Rrepet e Kuqarit
8. Pusi i Cilikojkave afër fshatit Çorrogunj


*Burimi i Ujit të Zi, Këlcyrë****Bashkia Tepelenë***

1. Shpella Mema e Ujit
2. Sterra e Cikës
3. Shpella e Lekë Petës
4. Shpella e Ujit –Dhëmbel
5. Vrima e Shkëmbit
6. Ujëvara e Progonatit
7. Shpella e Kasarit
8. Kanionet e Nivicës
9. Lugjet e Dhëmbelanit
10. Buza e Bredhit - Luzat
11. Rrapi i Selam Musait
12. Shpella e Mezhegoranit
13. Shpella e Leklit
14. Burimet e Ujit të Ftohtë
15. Tarraca erozive e Bënçës
16. Shkëmbi i Prerë Dukaj
17. Rrepet e Dervenit
18. Rrapi i Damës
19. Rrapi i Progonatit
20. Rrepet e Donies -Kalivaç
21. Rrepet e Ujit të Ftohtë
22. Lisi i Luzatit
23. Rrapi i Hormovës
24. Mrezhda e Zhabokikës


*Kanionet e Nivicës**Uji i Ftohtë Tepelenë*

Bashkia Memaliaj

1. Lisi i Levanit
2. Pusi i Shëndëllisë
3. Mogillat e Vasjarit
4. Triavgat në Gllavë
5. Rrapi i Qesaratit

*Mogillat e Vasjarit***Resurset Historike, Arkeologjike*****Kalatë e qarkut Gjirokastrë***

1. KALAJA E GJIROKASTRËS - Gjirokastrë
2. KALAJA E MELANIT - Nepravishtë
3. KALAJA E LABOVËS SË KRYQIT - Labovë e Kryqit
4. KALAJA SELOS - Selo Dropull i Sipërm
5. KALAJA E SHTËPEZËS - Shtëpëz Picar
6. KALAJA E JERMËS - Saraqinisht Antigone
7. KALAJA E KARDHIQIT - Kardhiq Cepo
8. KALAJA E LIBOHOVËS - Libohovë
9. KALAJA E SHËN TRIADHËS - Valare Lunxhëri
10. KALAJA në fshatin Paleokastër
11. KALAJA E PEPELIT - Pepel Dropull i Sipërm
12. KALAJA E TEPELENËS - Qendër Tepelenë
13. KALAJA E QYTEZËS - në fshatin Dukaj
14. KALAJA në fshatin Lekël
15. KALAJA në fshatin Matohasanaj
16. KALAJA në fshatin Kalivaç
17. KALAJA në fshatin Nivicë
18. KALAJA E ZHARËS - Dukaj Qendër Tepelenë
19. KALAJA në fshatin Horë, Tepelenë
20. KALAJA E KËLCYRËS - Këlcyrë
21. KALAJA E BOLENGËS - Përmet
22. KALAJA E LIMARIT - Këlcyrë

*Kalaja e Gjirokastrës**Kështjella e Shën Triadhës**Kalaja e Ali Pashës, Tepelenë**Kalaja e Kardhiqit*

1.11 KULTURA

Rajoni i Gjirokastrës karakterizohet nga një pasuri e madhe kostumesh, traditash muzikore dhe zakonesh popullore. Trashëgimia kulturore e Gjirokastrës, Lunxhit, Dropullit, Labërisë, Zagorisë, Libohovës, njihen për larmishmërinë dhe fuqinë e natyrshme të ruajtjes së tyre brez pas brezi. Vendbanimet e hershme, kalatë, tumat, kuvendet, dominojnë në të dy krahët e rrjedhës së lumit Drino, duke e cilësuar si një luginë që mbart thesare vlerash.

Gratë e këtyre zonave njihen për aftësinë që kanë për punimet e dorës, të cilat janë të trashëguara në breza. Kostumet tradicionale janë të zbukuruara mjeshtërisht me qëndisma dhe fije metalesh të cmuara; ato të Lunxhërisë dhe të Dropullit janë nga kostumet më të bukura që njihen në historinë

tonë. Të famshme në të gjithë vendin janë dantellat dhe punimet me grep të Gjirokastrës. Po ashtu prodhohen në mënyrë artizanale qilima e velenxa. Burrat përpunojnë drurin dhe gurin.

Kulinaria në rajonin e Gjirokastrës është e njohur për ushqimin e mirë si rezultat i përbërësve organikë të zgjedhur dhe të gatuar me mjeshtëri. Gjithashtu rajoni i Gjirokastrës njihet për produktet e qumështit e veçanërisht të djathit.

Muzika tradicionale polifonike shqiptare ka stilin e saj në Gjirokastrë me interpretime virtuozë të disa gjeneratave, përfshirë edhe një grup fëmijësh. E integruar në Iso-polifoninë shqiptare, ajo është njohur më 2005 nga UNESCO si *“trashëgimi kulturore e paprekshme”*.



Kostume tradicionale dropullite



Prodhime artizanale



Kostume tradicionale lunxhiote

Që prej vitit 1968 Gjirokastra është qyteti i festivaleve Folklorike Kombëtare. Për çdo katër vite mbledhen në kalanë historike grupe popullore nga Shqipëria, Italia, Kosova, Mali i zi, Diaspora etj, të cilët paraqesin dhe ruajnë trashëgiminë e vlerave folklorike.



Festivali Folklorik Kombëtar

Aktivitetet e shumta kulturore, ekspozitat ekoturistike të krahinave të ndryshme, panairot e agrobiznesit e kulinarisë etj, pasurojnë dhe promovojë krahinat e qarkut si destinacione të preferuara turistike. Vlen të përmendim aktivitetet të tilla si “Festojmë së bashku në divanin lunxhiot”, “Panairi i produkteve të bulmetit”, “Dita e verës” në qytetin e Përmetit, “Festa përmetare”, “Traditë, art, kulturë” në të cilën organizohen panairë agriturizmi me



Divani Lunxhot

prodhimet e zonës, konkurse poezie, pikturë dhe shfaqje folklorike. Gjithashtu, të larmishme janë dhe festat e organizuar në kuadër të çeljes së sezonit turistik me sfond fshatrat e bukura të Dropullit, Libohovës, Përmetit e Tepelenës. Rigjallërimi i traditave përmes ruajtjes, zhvillimit dhe promovimit të vlerave më të mira kulturore, etnografike e mjedisore ka tërhequr vëmendjen jo vetëm në nivel rajonal por edhe më gjerë.



Panairi artizanatit në Gjirokastrë

2.12 BESIMI FETAR

Në qarkun e Gjirokastrës ka mbi 51 kisha, 32 prej të cilave klasifikohen si tepër të rëndësishme për vlerat tipologjike dhe arkitektonike. Në jug të vendit për shkak të rrethanave historike dhe vazhdimësisë së jetës urbane e shpirtërore u ndërtuan në shekuj mjaft objekte kulti, që veç kultivimit të besimit fetar nga popullsia, përfaqësojnë dhe vlera të jashtëzakonshme artistike dhe

kulturore, që mund të shfrytëzohen mjaft mirë prej turistëve vendas e të huaj. Objektet e kultit si, kisha e Labovës së Kryqit dhe Teqeja e Melanit, mbartin në vetvete, jo vetëm vlera arkitektonike e shpirtërore, por edhe bashkëjetesën fetare të popullsisë ortodokse me atë myslimane, të origjinës shqiptare, greke, vllahe etj.



Teqeja e Melanit



Kisha e Shën Marisë



Xhamia e Pazarit

KAPITULLI II

Të dhëna të përgjithshme
Bashkitë e Qarkut Gjirokastrë

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR BASHKITË E QARKUT GJIROKASTËR

2.1 BASHKIA GJIROKASTËR

Popullsia: 52.140 banorë

Sipërfaqja: 469.2 km²

Densiteti: 110.93 banorë/km²

Kufizohet:

- në veri me bashkinë Tepelenë dhe Këlcyrë
- në lindje me bashkinë Libohovë
- në jug-lindje me bashkinë Dropull
- në perëndim dhe J-P me qarkun Vlorë

Ndarja Administrative:

- 1 qytet
- 7 njësi administrative
- 38 fshatra



Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Gjirokastrë	Qyteti Gjirokastrë	Gjirokastrë	Qyteti Gjirokastrë
		Cepo	Fshatrat; Fushëbardhë, Zhulat, Taroninë, Mashkullorë, Palokastrë, Çepun, Kodër, Plesat, Kardhiq, Prongji, Humelicë
		Lazarat	Fshatrat; Lazarat, Kordhocë
		Picar	Fshatrat; Picar, Shtëpëz, Kolonjë, Golem, Kaparjel
		Lunxhëri	Fshatrat; Qesorat, Dhoksat, Këllëz, Mingul, Nokovë, Erind, Gjat, Kakoz, Karjan, Valare
		Odrie	Fshatrat; Andon Poçi, Hundëkuq, Tërbuq, Labovë e Madhe, Labovë e Vogël
		Antigone	Fshatrat; Asim Zeneli, Arshi Lengo, Krinë, Tranoshisht, Saraqinisht

(bazuar në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”)

Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Gjirokastrës, i cili është një qytet tregtar i stilit otoman, ndër të paktët të tillë të mbijetuar në Ballkan. Bashkia e Gjirokastrës ka një histori të pasur me tradita të shkëlqyera atdhetare, arsimore e kulturore. Burimet kryesore të ekonomisë urbane në Gjirokastrë janë turizmi dhe manifaktura me material porositës, e cila shërben përgjithësisht për tregun e huaj. Zonat rurale

që i bashkëngjiten kësaj bashkie janë të njohura për blegtorinë e imtë dhe për produktet blegtorale shumë cilësore. Rijetëzimi i punimeve artizanale, i produkteve tradicionale ushqimore dhe i gastronomisë, pika turistike, burimet e shumta ujore dhe klima e përshtatshme mesdhetare-kodrinore, ka bërë që turizmi në këto zona të shënojë një hov cilësor gjatë viteve të fundit.

2.2 BASHKIA TEPELENË

Popullsia: 16.359 banorë

Sipërfaqja: 431.2 km²

Densiteti: 37.96 banorë/km²

Kufizohet:

- në veri me bashkinë Memaliaj
- në lindje me bashkinë Këlcyrë
- në jug me bashkinë Gjirokastrë
- në perëndim me bashkinë Himarë dhe Selenicë



Ndarja administrative:

- 1 qytet
- 4 njësi administrative
- 24 fshatra

Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Tepelenë	Qyteti Tepelenë	Tepelenë	Qyteti Tepelenë
		Qendër Tepelenë	Fshatrat; Dukaj, Salari, Turan, Mamaj, Veliqot, Bënçë, Dragot, Beçisht, Mezhgoran, Peshtan, Hormovë, Lekël, Kodër, Luzat
		Lopës	Fshatrat; Sinanaj, Matohasanaj, Dorëz, Dhëmbjan, Lab Martalloz
		Kurvelesh	Fshatrat; Progonat, Lekdush, Gusmar, Nivicë, Rexhin

(bazuar në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”)

Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Tepelenës. Ky qytet është një vendbanim i hershëm që lidhet me ndërtimin e një kështjelle në shek IV-VI, të ngritur në këtë pikë strategjike në kryqëzimin e rrugëve të Vjosës, grykës së Këlcyrës, Drinosit dhe Mallakastrës. Poshtë kështjellës ruhen gjurmë të një ure të madhe. Zhvillimi ekonomik i bashkisë Tepelenë bazohet në sektorin e shërbimeve, por gradualisht po rriten dhe aktivitetet me natyrë industriale, që konsiston në bizneset e industrisë së lehtë

dhe ushqimore si fabrika e “Ujit Tepelena”, por edhe përpunimin fillestar të bimëve medicinale. Territori i bashkisë ofron bukuri natyrore, të tilla si Lugina e Bënçës, Uji i Ftohtë, disa gryka malesh dhe lumenjsh, objekte arkeologjike si dhe mundësi të mëdha për të apasionuarit e alpinizmit, apo shetitjeve malore. Vend të posaçëm në trashëgiminë historike-kulturore zë padyshim kalaja e Ali Pashë Tepelenës.

2.3 BASHKIA PËRMET

Popullsia: 19.942 banorë

Sipërfaqja: 601.9 km²

Densiteti: 33.72 banorë/km²

Kufizohet:

- në veri me bashkinë Skrapar
- në lindje me bashkinë Kolonjë
- në perëndim me bashkinë Libohovë dhe Këlcyrë

Ndarja administrative:

- 1 qytet
- 5 njësi administrative
- 49 fshatra



Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Përmet	Qyteti Përmet	Përmet	Qyteti Përmet
		Çarçovë	Fshatrat; Çarçovë, Vllaho – Psilloterë, Biovizhdë, Zhepë, Draçovë, Iliar – Munushtir, Strëmbec, Pëllumbar, Kanikol
		Frashër	Fshatrat; Frashër, Zavalan, Ogren – kostrec, Gostivisht, Miçan, Vërçisht, Kreshovë, Soropull
		Petran	Fshatrat; Petran, Leshnicë, Leus, Lipë, Qilarishtë, Badilonjë, Benjë – Novoselë, Delvinë, Kaludh, Lupckë, Gjinakar, Ogdunan, Lipivan-Trabozishtë, Tremisht, Bodar
		Qendër Piskovë	Fshatrat; Piskovë, Bual, Kosinë, Rapckë, Mokricë-Zleushë, Kutal, Kosovë, Hotovë, Odriçan, Raban, Alipostivan, Borockë, Gosnisht, Pagri, Pacomit, Grabovë, Argovë

(bazuar në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”)

Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Përmetit. Ky qytet është ndoshta qyteti me më shumë sipërfaqe të gjelbëruara e lulishte dhe jo më kot është quajtur qyteti i luleve, trëndafilave, këngëve të pashoqe, pastërtisë dhe qetësisë. Bashkia e Përmetit rrethohet nga pasuri të rralla natyrore e monumentale, me potencial të rëndësishëm turistik si; Guri i Qytetit një masiv shkëmbor monumental befasues, ujërat termale të Bënjës dhe luginës së Lengaricës, bredhi i Hotovës etj,

Përveç turizmit, zhvillimi i ekonomisë bazohet dhe në sektorin e agro-industrisë përmes të cilit përmetarët njihen kombëtarisht. Glikotë, reçelnat, raketë, verërat e të tjera prodhime tradicionale lokale që prodhohen në punishtet dhe kantinat e kësaj zone, kanë gjetur tashmë vendin e tyre në tregun kombëtar. Përmeti është dhe vendlindja e vëllezërve Frashëri, shkrimtarët e mëdhenj të panteonit shqiptar.

2.4 BASHKIA KËLCYRË

Popullsia: 12.487 banorë

Sipërfaqja: 304.6 km²

Densiteti: 40.92 banorë/km².

Kufizohet:

- në veri me bashkinë Poliçan
- në lindje me bashkinë Skrapar
- në jug me bashkinë Përmet dhe Libohovë
- në perëndim me bashkinë Tepelenë dhe Memaliaj

Ndarja administrative:

- 1 qytet
- 4 njësi administrative
- 49 fshatra



Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Këlcyrë	Qyteti Këlcyrë	Këlcyrë	Qyteti Këlcyrë, Fshatrat; Fshat Këlcyrë, Mbrezhdan, Maleshovë, Limar, Leskaj
		Ballaban	Fshatrat; Ballaban, Vinokash, Vinokash Fushë, Komarak, Mazhar, Kondas, Psar, Ball, Kajtë, Pavar, Toshkëz, Bubës 1, Bubës 2, Beqaraj
		Sukë	Fshatrat; Sukë, Goricë, Fshat i Ri, Rodenjë, Podgoran, Podgoran Fushë, Ujmirë, Zhepovë, Shelq, Topojan, Luar, Delilaj, Çorogunj, Taroninë
		Dishnicë	Fshatrat; Beduqas, Tolar, Panarit, Riban, Varibop, Kuqar, Mërtinjë, Xhanaj, Bënjë, Fratar, Senican, Katundishtë, Leskovec, Gërdas, Kodrishtë

(bazuar në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”)

Bashkia Këlcyrë shtrihet në pjesën juglindore të vendit. Territori i bashkisë Këlcyrë është kryesisht me karakter kodrinoro-malor, i shtrirë midis vargmaleve Trebeshinë-Dhembël dhe malit të Qarrishtës. Ky territor përshkohet nga dy lumenj, i Vjosës dhe i Dëshnicës, rrjedha e të cilave krijon dy lugina të ngushta. Ekonomia lokale është tipike bujqësore dhe përbën sektorin kryesor ekonomik për popullatën lokale.

Zona e Këlcyrës është dalluar gjithmonë për cilësinë e lartë të frutave dhe rrushit dhe është njohur si qendër për kultivimin e rakisë dhe verës. Vera “Merlot”, e famshëm në këtë zonë, është e njohur në tregun vendas dhe më gjerë. Atraksionet turistike të kësaj zone janë të larmishme. Peizazhi i lumit Vjosë me ujëvara magjepëse, kanione e shpella të shumta, tërheqin çdo ditë e më shumë një numër të madh vizitorësh.

2.5 BASHKIA DROPULL

Popullsia: 22.964 banorë

Sipërfaqja: 448.2 km²

Densiteti: 49.56 banorë/km²

Kufizohet;

- në Veri-Perëndim dhe jug me bashkitë Libohovë, Gjirokastrë, Delvinë dhe Finiq
- në lindje ndan kufirin me Greqinë

Ndarja administrative:

- 3 njësi administrative
- 41 fshatra



Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Dropull	Jorgucat	Dropull i Poshtëm	Fshatrat; Dervican, Goranxi, Vanistër, Haskovë, Dhuvjan, Sofratikë, Terihat, Goricë, Frashtan, Lugar, Grapsh, Peshkëpi e Sipërme, Peshkëpi e Poshtme, Glinë, Vrahogoranxi, Radat
		Dropull i Sipërm	Fshatrat; Jorgucat, Zervat, Bularat, Bodrishtë, Kërrë, Vodhinë, Pepel, Klishar, Selo, Likomil, Llovinë, Krioner, Sotirë, Llongo, Koshovicë, Dritë, Kakavie, Vrisera
		Pogon	Fshatrat; Poliçan, Skore, Sopik, Çatistër, Mavrojer, Hllomo, Selckë

(bazuar në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”)

Bashkia e Dropullit shtrihet në pjesën Jug-Lindore të Shqipërisë. E ndodhur në kufi me Rajonin Ndërkufitar Greqinë dhe faktin që popullsia e saj është një popullsi minoritare bën që kjo bashki të ketë lidhje të ngushta me to, qoftë në terma ekonomike dhe punësim, ashtu edhe në aspekte të tjera që lidhen me historinë dhe kulturën e tyre të ngjashme. Ekonomia e kësaj zone është e bazuar kryesisht në bujqësi, blegtori, kultivim bimësh medicinale dhe

shërbime/tregëti. Përsa i përket zhvillimit të turizmit, vetë pozita gjeografike e favorizon mjaft zonën e Dropullit. Duke qenë midis Gjirokastrës dhe Janinës, dy qendra me atraksion botëror dhe nën mbrojtjen e UNESCO-s, si dhe falë potencialeve vendase si bujqësia, blegtoria, kultivimi i bimëve medicinale, kulinaria, trashëgimia arkitektonike dhe objektet e kultit, bëjnë që turizmi të jetë sektor kryesor në zhvillimin ekonomik të zonës.

2.6 BASHKIA LIBOHOVË

Popullsia: 7.116 banorë

Sipërfaqja: 248.2 km²

Densiteti: 28.83 banorë/km²

Kufizohet:

- në veri me bashkinë Këlcyrë
- në lindje me Bashkinë Përmet
- në jug me bashkinë Dropull
- në perëndim me bashkinë Gjirokastrë

Ndarja administrative:

- 1 qytet
- 3 njësi administrative
- 17 fshatra



Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Libohovë	Qyteti Libohovë	Libohovë	Qyteti Libohovë
		Qëndër Libohovë	Fshatrat; Labovë e Sipërme, Labovë e Poshtme, Suhë, Stegopull, Bulo, Drino, Nepravishtë
		Zagorie	Fshatrat; Sheper, Nivan, Konckë, Vithuq, Hoshtevë, Doshnicë, Zhej, Lliar, Topovë, Nderan

(bazuar në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”)

Qendra e bashkisë Libohovë është qyteti i Libohovës. Zona është e pasur me monumente arkeologjike, historike, monumente kulti dhe natyrore, me vlera unike në llojin e vet, të vizitueshme në çdo kohë dhe të njohura ndërkombëtarisht. Libohova ka potenciale të jashtëzakonshme për të nxitur zhvillimin e sektorit të turizmit. Një nga atraksionet turistike është Kalaja e Libohovës, e ndërtuar rreth vitit 1800,

dhurata që Ali Pashë Tepelena i bëri motrës së tij Shanishasë, rapi 550 vjeçar, etj. Zona e Libohovës është e njohur për shumëllojshmërinë e bimëve etero-vajore dhe medicinale që ka në territorin e vet si sherebela, rigoni etj. Përpunimi i tyre është një traditë e hershme dhe e trashëguar për shumë familje libohovite.

2.7 BASHKIA MEMALIAJ

Popullsia: 21.035 banorë

Sipërfaqja: 372.07 km²

Densiteti: 16.6 banorë/km²

Kufizohet:

- në veri me bashkinë Mallakastër,
- në lindje me bashkinë Këlcyrë,
- në jug me bashkinë Tepelenë
- në perëndim me bashkinë Himarë dhe Selenicë

Ndarja administrative:

- 1 qytet
- 6 njësi administrative
- 53 fshatra



Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Memaliaj	Qyteti Memaliaj	Memaliaj	Qyteti Memaliaj
		Memaliaj Fshat	Fshatrat; Memaliaj Fshat, Vasjar, Cerrilë, Mirinë, Damës, Kallëmb, Kashisht, Bylysh
		Luftinjë	Fshatrat; Izvor, Luftinjë, Luftinjë e Sipërme, Rrapaj, Rabie, Gllavë e Vogël, Maricaj, Arrëz e Madhe, Vagalat, Tosk Martalloz, Dervishaj, Zhapokikë, Zhapokikë e Sipërme, Ballaj, Luadhaj
		Buz	Fshatrat; Buz, Kalemaj, Badër, Kurtjez, Golemaj, Arrëz e Vogël, Shalës, Xhafaj, Gllavë, Selckë, Selckë e Vogël, Komar, Bardhaj
		Krahës	Fshatrat; Krahës, Krahës i Sipërm, Zhulaj, Lulëzim, Levan, Allkomemaj, Kalivaç, Përparim, Leshnjë, Xhaxhaj
		Qesarat	Fshatrat; Qesarat, Iliras, Amanikaj, Toç, Anëvjosë, Koshtan, Kamçisht

(bazuar në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”)

Bashkia Memaliaj shtrihet në V-P të qarkut Gjirokastrë dhe rrethohet nga tre anë nga lumi Vjosë duke i dhënë trajtën e një gadishulli. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti Memaliaj. Duke pasur një peisazh të larmishëm gjeografik, territori i saj krijon potencial turistik sidomos për sportin e eksplorimit. Përveç pasurive natyrore të larmishme si shpella, kanione, lugina, pasuri

nëntokësore, botanike e shtazore, ka edhe një numër objektesh arkeologjike të periudhës ilire (ndërtime të fisit epiriot të kaonëve) dhe të epokave më të vonshme. Bashkia Memaliaj është e njohur për burime minerare, në formën e rezervave të gypurgurit me fuqi të lartë kalorifike (por me përqindje të lartë squfuri, 3 herë më tepër se normat e BE), burime të cilat i ka dhe sot.

KAPITULLI III

Monitorimi dhe Zbatimi i Politikave të Këshillit
të Ministrave në Qarkun Gjirokastrë

3.1 ARSIMI

Rajoni i Gjirokastrës njihet për përpjekjet e atdhetarëve të saj për hapjen e shkollave shqipe. Nga shkollat e saj kanë dalë shkrimtarë të mëdhenj, kuadro të shkencës shqiptare e politikanë të shquar. Aktualisht në qytetin e Gjirokastrës kryen funksionin e tij universiteti “Eqrem Çabej” i cili u krijua më 12 nëntor 1991. Ai është institucioni më i rëndësishëm arsimor, shkencor e kulturor i Rajonit Jugor të Shqipërisë.



Gjithashtu, institucion arsimor i rëndësishëm në qark është dhe gjimnazi i njohur i Gjirokastrës, “Asim Zeneli”, një nga më të njohurit edhe përtej Ballkanit. Ai u themelua më 5 nëntor 1923. Dikur ky gjimnaz, i cili është afërsisht në moshë sa vetë shteti shqiptar, njihet si Liceu Francez i Gjirokastrës. Nga dyert e këtij gjimnazi kanë dalë nxënës që lanë gjurmë në shkencën, politikën, artin dhe letërsinë shqipe. Të kësaj shkolle janë shkrimtarët e njohur Ismail



Gjimnazi "Asim Zeneli"

Kadare dhe Dritëro Agolli.

Duke qenë se cilësia në edukim shkon përkrah cilësisë së ardhme të shoqërisë, për përmirësimin e saj kërkohet bashkërendimi i të gjithë aktorëve dhe faktorëve përgjegjës, duke përcaktuar detyrimet ndërinstitucionale dhe duke rritur përgjegjshmërinë në mirëqeverisjen e arsimit. Vitet e fundit në qarkun Gjirokastrë vihet re një qasje positive kundrejt përmirësimit të mësimdhënies por edhe përzgjedhjes “së zgjuar” që nxënësit bëjnë për të ardhmen e tyre, kjo në sajë edhe të reformës arsimore, hartimit të politikave të zhvillimit të arsimit dhe realizimit të programeve integruese që ndërmerr qeveria shqiptare.

Në këtë kuadër, institucioni i Prefektit ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e politikave në arsimin parauniversitar, me qëllim që këto reforma të funksionojnë dhe të japin inpaktin e dëshiruar. Bazuar në informacionet e marra nga DAR Gjirokastrë, gjatë vitit 2018 është bërë përmirësimi i infrastrukturës bazë si dhe janë përmirësuar kushtet për zhvillimin e një procesi normal mësimor, me krijimin e laboratorëve të informatikës dhe sigurimin e internetit në të gjitha shkollat. Gjithashtu, janë krijuar struktura mbështetëse për zhvillimin e mësimin për nxënësit me aftësi ndryshe duke caktuar mësues mbështetës për një zhvillimin normal të procesit mësimor për këta nxënës. Numri i nxënësve të regjistruar në klasën e parë për vitin shkollor 2018-2019 në qarkun e Gjirokastrës është 735 nxënës. Krahasuar me vitin e kaluar, vihet re një rënie e numrit të nxënësve të cilët janë regjistruar e vazhdojnë shkollën, si pasojë jo vetëm nga lëvizja e popullsisë por edhe nga rënia e numrit të lindjeve.

1. Institucione arsimore, DAR Gjirokastër

Nr.	Institucione Arsimore	Arsimi publik	Arsimi jopublik
1	Kopshte	18	2
2	Shkolla 9-vjeçare	9	2
3	Shkolla të mesme të bashkuara (ShMB)	4	2
4	Klasa Arsimit Fillor (vartëse)	5	
5	Gjimnaze të përgjithshme	3	
6	Gjimnaz gjuhësor	1	
7	Shkollë e mesme artistike	1	
8	Shkollë e mesme profesionale	1	

a. Të dhënat statistikore për numrin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar, DAR Gjirokastër

Nr.	Arsimi	Arsimi parashkollor		Arsimi mesëm i ulët		Arsimi i mesëm i lartë	
		Nxënës gjithësej	Femra	Nxënës gjithësej	Femra	Nxënës gjithësej	Femra
1	PUBLIK	1054	486	2980	1444	1251	578
2	JOPUBLIK	157	85	459	232	40	7
3	TOTALI	1211	571	3439	1676	1291	585

2. Institucione arsimore, ZA Tepelenë

Nr.	Institucione Arsimore	Arsimi publik
1	Kopshte	42 (2 me drejtorin të tjerat në varësi)
2	Shkolla 9-vjeçare	9 me drejtorin (me 46 klasa vartëse)
3	Gjimnaze të përgjithshëm	2
4	Klasa Arsimit Fillor (vartëse)	46
5	Shkolla të mesme të bashkuara (ShMB)	4

b. Të dhënat statistikore për numrin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar, ZA Tepelenë

Nr.	Arsimi	Arsimi parashkollor		Arsimi mesëm i ulët		Arsimi i mesëm i lartë	
		Nxënës gjithësej	Femra	Nxënës gjithësej	Femra	Nxënës gjithësej	Femra
1	PUBLIK	679	366	1864	941	577	330
2	JOPUBLIK						
3	TOTALI	679	366	1864	941	577	330

3. Institucione arsimore, ZA Përmet

Nr.	Institucione Arsimore	Arsimi publik
1	Kopshte	15
2	Shkolla 9-vjeçare	5 me drejtori (me 28 klasa vartëse)
3	Shkolla të mesme të bashkuara (ShMB)	2
4	Klasa Arsimi Fillor (vartëse)	28
5	Gjimnaze të përgjithshëm	3

c. Të dhënat statistikore për numrin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar, ZA Përmet

Nr.	Arsimi	Arsimi parashkollor		Arsimi mesëm i ulët		Arsimi i mesëm i lartë	
		Nxënës gjithësej	Femra	Nxënës gjithësej	Femra	Nxënës gjithësej	Femra
1	PUBLIK	380	192	1353	622	535	262
2	JOPUBLIK						
3	TOTALI	380	192	1353	622	535	262

(burimi i informacionit; DAR Gjirokastrë)

3.2 SHËNDETËSIA

Situata shëndetësore në qarkun Gjirokastrë paraqitet me probleme për shkak të periudhës së vështirë të tranzicionit e cila ka lënë gjurmë në çdo sektor ekonomik dhe social të vendit, megjithatë treguesit statistikorë tregojnë përmirësim të ndjeshëm si në shërbimin shëndetësor parësor dhe në atë spitalor. Reformat e nisura në sistemin shëndetësor kanë filluar të ndjehen dhe të përqafohen nga banorët e qarkut si dhe të inkurajohen për përmirësime të mëtejshme. Konsolidimi i institucioneve bazë që ofrojnë shërbime si poliklinikat, qendrat

shëndetësore, ambulancat dhe shërbimet e veçanta të konsultorit të fëmijëve dhe të gruas, ka rritur numrin e shërbimeve si dhe cilësinë e tyre ndër vite. Në kuadër të Programit Kombëtar, ndërmarrë nga qeveria shqiptare për rindërtimin e 300 qendrave të reja shëndetësore në 3 vjet, gjatë këtij viti në qark u rindërtuan 8 qendra shëndetësore. Në vazhdim do të rehabilitohen gjithësej 22 qendra shëndetësore dhe pika autoambulancash, për t'u ofruar qytetarëve një shërbim sa më cilësor.

Përsa i përket shërbimit shëndetësor, aktualisht në rajon kryejnë funksionin:

Spitale: 3 (Gjirokastrë, Tepelenë dhe Përmet)

Qendra shëndetësore: 31

Ambulanca: 158

Konsultore e fëmijëve: 167

Numri më i madh i instucioneve shëndetësore është përqëndruar në qytetet ku dhe numri i popullsisë është më i lartë. Bazuar në statistikat e INSTAT mbi shërbimin spitalor, rezulton se qarku Gjirokastrë ka dëndësinë më të lartë të shtretërve spitalor, gati 57 shtretër për 10 mijë banorë. Institucioni shëndetësor kryesor i rajonit i cili ofron shërbim spitalor për një numër të konsiderueshëm banorësh, jo vetëm për popullsinë lokale por dhe për popullsinë banuese nga zonat përreth, është Spitali Rajonal “Omer Nishani” i qytetit të Gjirokastrës. Ky spital, në të cilin shërbejnë

rreth 242 personel dhe ka kapacitet 190 shtretër, është i kompletuar me të gjitha shërbimet spitalore ku përfshihen dhjetra reparte shërbimi spitalor, si reparti i urgjencave, pediatria, patologjia, infektiv, reanimacioni, dializa, kirurgjia, materniteti, radiologjia dhe laboratorë për kryerjen e të gjitha analizave dhe egzaminimeve mjekësore.

Gjithashtu, që prej fillimit të këtij viti ky spital ofron falas një shërbim të domosdoshëm për të gjitha gratë dhe vajzat; mamografinë.

3.3 TURIZMI

Zhvillimi i turizmit për Qarkun e Gjirokastrës është një nga rrugët më efikase për ringritjen ekonomike dhe si rrjedhojë reduktimin e varfërisë në zonat rurale dhe urbane. Potenciali i madh turistik i qarkut shprehet, përveç të tjerash, edhe në ekzistencën burimeve të shumta turistike që ofron zona duke përmbyshur të gjitha kriteret për zhvillimin e turizmit kulturor, turizmit të gjelbër dhe atij rural.

Turizmi kulturor

Ky lloj turizmi ishte më i përhapuri deri tani në qarkun tonë dhe kryesisht në qytetin e Gjirokastrës, pasi është nga të vetmit qytete të Europës që vazhdon të ruaj një zonë të gjerë me ndërtime mesjetare, me një arkitekturë të rrallë, me pasuri të çmuara të trashgimisë kulturore dhe historike. Vetë qyteti është një amfiteatër gjigant i ndërtuar në 5 shpate mali dhe në qendër të tij ndodhet kështjella historike nga ku e ka zanafillën ky qytet. Në qarkun Gjirokastrë ndodhen edhe

12 kala të cilat, falë edhe vëmendjes që po i kushtohet vitet e fundit, ngjallin kërshërinë e shumë vizitorëve të cilët kanë dëshirën për t’i zbuluar dhe njohur akoma dhe më shumë historinë e krijimit të tyre.

Gjithashtu, burimet e zhvillimit të turizmit kulturor plotësohen më tej edhe me pasuritë arkeologjike në zbulim e sipër të luginës së Drinos ku epiqendra është qyteti i lashtë i Antigonesë dhe amfiteatri i Adrianopolit.

Kuadrin e burimeve të zhvillimit të turizmit kulturor, e plotësojnë edhe një sërë objektesh kulti të shpërndara në gjithë rajonin, në të cilat ndodhen afreske kishtare me ikona të mrekullueshme dhe shumë të vjetra. Të gjitha këto objekte historike, të cilat duhet të mirëmbahen, plotësojnë kushtet për t’u vizituar nga turistët në fondin kohor rreth tri ditë.

Turizmi i Gjellbër

Burimet e rajonit tonë plotësojnë kushtet për zhvillimin e të gjitha formave të turizmit të gjellbër si:

- Zhvillimi i turizmit alpin
- Zhvillimi i turizmit lumor sportiv
- Zhvillimi i turizmit eksplorues

Terreni malor i qarkut të Gjirokastrës dhe sidomos i kanioneve të malit të Nemëçkës mbi fshatin Kaludh nga ana e Përmetit, e kanioneve të luginës së Bençës, krijojnë mundësira jo vetëm për zhvillimin e turizmit alpin, por edhe të organizimit të kampionateve botërore të alpinizmit, tani më e studiuar edhe nga specialistë të huaj.

Turizmi Rural (Eko-Turizmit)

Vitet e fundit, turizmi rural po zhvillohet me ritme të kënaqshme, falë dhe programeve të ndërmarra nga qeveria shqiptare por dhe investitorë privat, për promovimin dhe krijimin e kushteve të përshtatshme turistike sidomos në zonat e thella. Në politikat për turizmin, vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe investimeve infrastrukturore në funksion të zhvillimit të zonave me potenciale turistike. Menaxhimi i saktë i informacionit, kthimi i shumë banesave rurale në bujtina duke promovuar zakonet, jetën e fshatit dhe mënyrën e të ushqyerit, ka bërë që ky lloj turizmi të realizohet duke ardhur grupe të vogla turistësh të cilët qëndrojnë nëpër fshatra disa ditë duke treguar interes për gjithçka që zona ofron.

Qarku i Gjirokastrës përshkohet nga një skaj në tjetrin prej një sërë monumentesh me vlera historike dhe arkeologjike si dhe me vlera ambientale dhe peisazhistike. Zona muzeale e Gjirokastrës, si përfaqësuesja më e dukshme e vlerave historike artistike, arkitektonike e urbanistike të

Sistemi specifik i lumit të Vjosës krijon kushte të plota për zhvillimin e turizmit lumor sportiv. Shpellat e shumta me stalagmite dhe stalaktite në Progonat dhe Nivicë të Kurveleshit, shumica të paeksploruara, krijojnë mundësinë e organizimit të turizmit eksplorues. Zhvillimin e turizmit të gjellbër e stimulojnë edhe ekzistenca e një sërë monumentesh natyrorë, që natyra ia ka falur qarkut të Gjirokastrës. Po kështu fusha e Çajupit, Llufa e Nivicës në Kurvelesh dhe Ujrat termale të Bënjës në rrethin e Përmetit, për aftësitë e mëdha kurative që ato mbartin mund të bëhen vatra të rëndësishme për tërheqjen e turistëve.

papërsëritshme, e pasuar nga monumente të tjera arkeologjike, e historike me vlera të çmuara si Antigonea, Teatri i Adrianopolit, zonat arkeologjike të Leklit, Matohasanaj, Nivicës, kalaja e Ali Pashës në Tepelenë, kisha e Labovës së Kryqit, e Zervatit, Goranxisë, Poliçanit, Manastiri i Cepos, i Spilesë, kompleksi i kishave të Sotirës etj, krijojnë resurse për zhvillimin e turizmit në qarkun e Gjirokastrës. Të kombinuara këto me një sërë zonash të tjera me veçori ambientale si zona e Sotirës, Çajupit, Viroit, Bredhit të Hotovës, Zona e Lengaricës, Shpella e Pëllumbave dhe pylli i Maqellarës, Bredhi i Kalasë, Shpella e Spilesë, Uji i Ftohtë i Tepelenës dhe Llufa e Kurveleshit e shumë të tjera i japin turizmit në zonë një dimension tjetër. Dy lumenjtë kryesorë që përshkojnë qarkun, ai i Drinos dhe Vjosës krijojnë resurse ekonomike në drejtim të shfrytëzimit të energjisë së ujrave të tyre e kultivimit të peshkut dhe mundësi për zona plazhistike.

Vitet e fundit, politikat e qeverisë në lidhje me trashëgiminë kulturore janë orientuar në funksion të zhvillimit të turizmit, kështu, vlen të përmendim investimet në restaurimin e Qendrës Historike dhe Qafën e Pazarit, shtëpinë e Ismail Kadaresë, kalanë e Gjirokastrës, qendrat e bashkive të qarkut, restaurimin e shumë banesave monument kulture dhe objekteve fetare etj. Gjithashtu, në qark po materializohet Programi i Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR) – Programi i 100 fshatrave, nismë e qeverisë shqiptare, i cili synon të koordinojë ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave. Në këtë program janë përzgjedhur 13 fshatra të qarkut Gjirokastrë. (shih fq. 63). Një nismë tjetër për promovimin e turizmit ishte dhe “Smile Albania”, një projekt i ri i cili synonte prezantimin e resurseve, aseteve si dhe propagandimin e burimeve natyrore e kulturore që ka qarku ynë. Shumë të rinj të qarkut Gjirokastrë u bënë pjesë e këtij projekti duke dhënë informacionet e nevojshme tek turistët, duke ndihmuar në organizimin e mikpritjes dhe reklamimin e trashëgimive natyrore e kulturore. Gjithashtu, ndërgjegjësimi i bizneseve në bashkëpunim me strukturat shtetërore qëndrore kanë bërë të mundur promovimin e turizmit në zonat e thella me potenciale turistike. Praktikimi i sporteve të reja si: ngjitje e guiduar me këmbë nëpër shtigje malore, kalërim në natyrë, rafting, udhëtime me biçikleta malore dhe mjete 4×4 po e radhit Gjirokastrën në një prej destinacioneve më të rëndësishme të turizmit të aventurës në vend. Vlen të përmendim investimin në fermën e kuajve në Lunxhëri “Caravan Horse Riding Albania”, e cila organizon ture në parkun e Antigonesë, në fshatin Asim Zeneli, Zagori, në zonën e Përmetit etj, për turistët që duan të bëhen pjesë e turizmit eksplorues.



“Caravan Horse Riding Albania”

Sezoni turistik 2018 ka patur një rritje të interesit nga vizitorët vendas dhe të huaj për të vizituar qarkun e Gjirokastrës dhe veçanërisht qytetin e Gjirokastrës. Shtimit të kapaciteteve akomoduese i është përgjigjur rritja e numrit të turistëve gjatë sezonit turistik.. Në bashkinë Gjirokastrë, sipas të dhënave të mbledhura nga InfoPoint dhe hotelet, më shumë se gjysma e vizitorëve që kanë qenë në qytet kanë kaluar të paktën një natë në Gjirokastrë. Përveç burimeve turistike, një ndikim pozitiv në kohëzgjatjen e qëndrimit të turistëve kanë patur gatimet karakteristike dhe produktet tradicionale të zonës si dhe aktivitetet tradicionale e festat lokale, ku një pjesë e mirë e tyre si, veprimtari artistike, folklorike, panaire të etnokulturës, kulinarisë etj, zhvillohen pranë qendrave historike duke bërë të mundur ruajtjen, mbrojtjen, promovimin dhe propagandimin e të gjithë trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore që ka kjo zonë.

Bazuar në të dhënat statistikore për vitin 2018, numri i vizitorëve vendas dhe të huaj që kanë vizituar qarkun tonë ishte 162 995 vizitorë rreth 52.57% më shumë se viti 2017 dhe konkretisht;

Bashkia Gjirokastrë: 114 278 vizitorë

Bashkia Përmet: 26000 vizitorë

Bashkia Tepelenë: 8000 vizitorë

Bashkia Libohovë: 9200 vizitorë

Bashkia Dropull: 3000 vizitorë

Bashkia Këlcyrë: 1517 vizitorë

Bashkia Memaliaj 1000 vizitorë

Zonat më të frekuentuara nga turistët e huaj dhe vendas ishin: Kalaja e Gjirokastrës, Muzeu Etnografik, Pazari i Vjetër, Shtëpitë Muze, Mali i Çajupit, Bredhi i Sotirës në Njësinë Administrative Dropull i Sipërm, Parku i Viroit, Tuneli i Luftës së Ftohtë, Parqet arkiologjike Antigonea dhe

Adrianopuli, Kisha në Labovën e Kryqit, Gryka e Këlcyrës, Ujrat Termale në lumin Langaricë, Bredhi i Hotovës në Njësinë Administrative Piskovë, Lugina e Lumit Vjosë, e cila është frekuentuar për “Kanotazh” nga turistët e huaj, Kalaja e “Ali Pashës” Tepelenë, Uji i Ftohtë në Tepelenë, Kanionet e Nivicës në njësinë administrative Kurvelesh etj. Gjatë vitit 2018, Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë ka ndjekur hap pas hapi ecurinë e sezonit turistik në të gjithë rajonin tonë dhe ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me institucionet përgjegjëse për t’u informuar mbi masat e marra, me qëllim jo vetëm mbarëvajtjen e një sezoni turistik të suksesshëm por dhe për të bërë të mundur që sitet turistike të kthehen në qendra të vizitueshme dhe në muze të hapur për vizitorët gjatë gjithë vitit.



Muzeu i armëve



Shtëpia e Zekateve



Muzeu Etnografik



Ujrat termale, Bënjë

3.4 MJEDISI

Mjedisi në të cilin jetojmë është shumë i rëndësishëm për ne. Ai është burim i jetës së njeriut. Fatkeqësisht, vitet e tranzicionit në vendin tonë patën një ndikim negativ në ruajtjen e natyrës e të mjedisit. Një mjedis i shkatërruar ndikon në klimën e vendit, në shëndetin publik, në ekonomi, në turizëm, në imazhin e vendit dhe në imazhin e vetë njerëzve. Çdo problem që i kanoset mjedisit duhet të merret në konsideratë nga të gjithë, sepse kujdesi ndaj tij është edhe kujdesi ndaj shëndetit dhe shoqërisë sonë. Sigurimi i një natyrë e mjedis të pastër mbetet një nga prioritetet kryesore dhe duhet të praktikohet jo vetëm në nivel të organizatave apo qeverisë por kërkon një ndërgjegjësim dhe përgjegjësi individuale, pasi njëherë e mirë duhet të kuptohet se të jetosh mirë nuk mjafton ta kesh shtëpinë e mirë por duhet aspiruar dhe për një lagje më të mirë, për një qytet më të pastër e më të sigurtë. Gjithkush mund të kontribuojë sadopak për mjedisin. Ka ardhur koha që të gjithë së bashku t'i themi “STOP!” prerjes së pemëve, ndotjes së ajrit, tokës dhe ujërave.

Në këtë kuadër, viti 2018 ishte një vit sfidë i qeverisë shqiptare për mbrojtjen e mjedisit, pastrimin e territorit nga mbetjet urbane dhe ato inerte. Gjatë këtij viti u ndërmorën nisma të rëndësishme, me inpakt të drejtpërdrejt për qytetarin, mbështetës të së cilave ishte edhe Qarku i Gjirokastrës. Ndër më kryesoret vlen të përmendim aksionet që u zhvilluan në kuadër të “Javës së tokës”, ku nën logon “Për një Shqipëri të pastër turistike”, është zhvilluar aksioni “Të pastrojmë Shqipërinë që duam” dhe “Krijo oksigjenin tënd”. Këto nisma, të cilat do të vazhdojnë dhe në vitet në vazhdim, u ndërmorën nga Ministria e Turizmit dhe

Mjedisit, me qëllimin mbrojtjen nga ndotja me mbeturina e mjedisit urban dhe mbajtjen e një mjedisi të shëndetshëm për të gjithë.

Politikat mjedisore po zhvillohen në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, duke ruajtur burimet natyrore nga ndotja, si dhe duke promovuar vlerat mjedisore. Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë, ka qenë një nga promotorët kryesor të zbatimit të tyre në rajonin tonë si dhe ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme situatën dhe ka kërkuar nga institucionet shtetërore përgjegjëse, informacione mbi ecurinë dhe masat e marra mbi problematikat e ndryshme që mund të jenë hasur gjatë zhvillimit të tyre.

Bazuar në të dhënat administrative, institucionet shtetërore përgjegjëse kanë monitoruar situatën në vazhdimësi duke kryer kontrolle dhe inspektime në subjekte që janë përdorues të materialeve inerte lumore. Konkretisht gjatë vitit 2018, Dega Rajonale e ISHMPU, ka kryer gjithsej 57 inspektime të ndara në 45 inspektime (online) në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe kontrollin e subjekteve dhe 12 inspektime në fushën e mbrojtjes së Pyjeve.

Në kontrollin e ushtruar nga grupi i punës është vënë re se në të gjithë basenin ujqor Vjosa, asnjë prej subjekteve nuk ka rezultuar i pajisur me leje për shfrytëzimin e materialeve inerte lumore. Problematikë ngelet mos pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe ndalimit të shfrytëzimit, Në segmente të ndryshme të lumenjve Vjosë, Drino e degëve të tyre, ka akumulime të mëdha sasish të materialeve inerte.

Si pasojë, në disa segmente, prurjet e mëdha të lumenjve, kanë krijuar devijim të rrjedhës natyrore të shtretërve të lumenjve, duke marrë drejtim në brigjet anësore të tyre e

duke krijuar erozion në tokat përreth. Në zbatim të ligjit Nr. 9115/2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” janë evidentuar dhe regjistruar të gjitha subjektet që shkarkojnë ujëra të ndotura pranë zonave turistike. Problem kryesor janë shkarkimet organike nga rrjeti i kanalizimeve direkt në lumë ku asnjë prej bashkive të qarkut, nuk

është i pajisur me impjant për trajtimin e ujërave të zeza.

Sektori i Policisë Pyjore të Degës Rajonale të ISHMPUT ka kryer inspektime në pyje, kullota, gjueti, bimë medicinale eterovajore e tanifere si dhe ka kryer fushata sensibilizuese për mbrojtjen e pyjeve dhe faunës së egër në të shtatë bashkitë e qarkut.

3.5 EKONOMIA

Ekonomikisht rajoni ka potenciale të shumta turistike, bujqësore, blegtorale, si dhe në sektorin e shërbimeve dhe industrisë përpunuese. Ndonëse nuk disponohen të dhëna më të detajuara në nivel njësie vendore, konfigurimi i zonës funksionale të re sugjeron se, me përjashtim të bashkisë Gjirokastrës, pjesa më e madhe e njësive të reja të përfshira kanë karakter bujqësor. Kjo mbështetet edhe nga të dhënat mbi shpërndarjen e bizneseve në këto zona ku mbi 80% e të cilave janë të vendosura në qytetin e Gjirokastrës. (të dhënat bazuar INSTAT 2017).

Njësi të ndryshme biznesesh janë të përqëndruara përgjatë boshtit kryesor rrugor Gjirokastrë - Kakavie, ku një pjesë e tyre përfaqësojnë bizneset më të mëdha që operojnë në Shqipëri dhe janë të një rëndësie kombëtare e ndërkombëtare si (ELKA, Vikos, Glina, Dhimitra, Gjirofarma, Progress Trust shpk, Living Eater) etj.

Më pak se 30% e të punësuarve në zonë, me përjashtim të qytetit të Gjirokastrës, veprojnë në sektorin e bujqësisë, ndërkohë që ndërtimi dhe shërbimet punësojnë një përqindje të lartë të popullsisë.

Vitet e fundit sipërmarrësit fason kanë shtrirë bizneset e tyre në disa zona të qarkut Gjirokastrë në të cilën punësohen një numër i konsiderueshëm punonjësish, kryesisht femra. Duke qenë se papunësia në rajon është në shifra të larta, Prefekti i qarkut ka organizuar vazhdimisht takime me sipërmarrës të ndryshëm me qëllim njohjen nga afër të mundësive që ofron tregu i punës dhe rritjen e kapaciteteve të punësimit, sidomos për kryefamiljarët meshkuj. Sipërmarrësit fasonë gjatë takimeve me Prefektin e Gjirokastrës, shprehën gatishmërinë e tyre për rritjen e kapacitetetve të punësimit dhe përmirësimin e kushteve në punë të punonjësve. Madje, vetë pronarët e këtyre linjave prodhuese kanë ofruar transportin e punonjësve të rinj nga rrethet e tjera brenda qarkut, së bashku me ofrimin e kujdesit për fëmijët me ndërtimin e kopshteve dhe çerdheve pranë bizneseve të tyre. Nisma të tilla koordinuar me politikën ekonomike të qeverisë, që kanë për qëllim sigurimin e kushteve sa më optimale sociale dhe sigurimin e kushteve për një klimë të favorshme për zhvillimin e biznesit dhe investimeve të huaja, konsiderohen si tepër të rëndësishme për arritjen e objektivave ekonomiko-shoqërore të një vendi dhe mbrojtjen e interesave të shoqërisë në tërësi.

a. Subjekte private:

Bashkia	Nr. i bizneseve
Gjirokastrë	1600
Libohovë	44
Dropull	163
Tepelenë	312
Memaliaj	143
Përmet	538
Këlcyrë	103
Total i qarkut	2903

(të dhënat bazohen nga verifikimi kryer nga UK.sh si rezultat i Reformës së ujit të pijshëm, viti 2018)

Përsa i përket Operatorëve të Biznesit Ushqimor (OBU), bazuar në të dhënat administrative që raportohen nga Drejtoria Rajonale AKU Gjirokastrë, në qark ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së produkteve ushqimore 908 Operatorë Biznesi Ushqimor (OBU). Ndërkohë sipas fushës së veprimtarisë shpërndarja e OBU, paraqitet si më poshtë:

Nr.	Operatorë Biznesi Ushqimor	Numri
1	Trajtim ambalazhim uji	4
2	Prodhim pije freskuese, lëngje frutash dhe birre	4
3	Prodhim përpunim me bazë brumi	7
4	Fruta të thata ambalazhim	2
5	Restorante	142
6	Piceri-fast food	40
7	Bar-kafe	230
8	Supermarkete	16
9	Njësi tregëtim dhe markete	204
10	Prodhim përpunim pije alkoolike	9
11	Njësi prodhim tregëtim buke (furrë buke)	49
12	Njësi prodhim tregëtim embëlsirash	13
13	Përpunim frutash/konservim	16
14	Grupe të vaçanta	20
15	Njësi tregëtim mishi	47
16	Njësi tregëti peshku	2
17	Njësi tregëti bulmeti	9
18	Fabrikë përpunim qumështi të automatizuara	4
19	Fabrikë përpunim qumështi 1/2 automatizuara	10
20	Baxho	20
21	Stabiliment përpunimi me bazë mishi (Sallameri)	2
22	Produkte të ngrira/të freskëta të paketuara	3
23	Thertore	3
24	Përpunim ambalazhim mjalti	1

(Bazuar në të dhënat e Drejtorisë Rajonale AKU Gjirokastrë)

3.6 BUJQËSIA

Qeveria shqiptare, gjatë kësaj periudhe i ka kushtuar një rëndësi të veçantë politikave bujqësore dhe zhvillimit rural. Këto politika synojnë të rrisin produktivitetin e bujqësisë, të sigurojnë një nivel jetese të drejtë të popullsisë që merret me bujqësi, të stabilizojnë tregjet, të garantojnë sigurinë e furnizimeve si dhe të sigurojnë çmime të arsyeshme për konsumatorët. Rajoni i Gjirokastrës ka potencialet e duhura për të përfituar nga masat dhe mënyrat se si qeveria planifikon mbështetjen financiare në një periudhë kohore të dhënë, në të mirë të bujqësisë dhe zonave rurale. Vlen të përmendim investimin e kryer në hapjen e inkubatorit të parë të produkteve tipike shqiptare, në Përmet. Ky investim është mbështetur në 70% të vlerës nga skemat kombëtare të mbështetjes në bujqësi për vitin 2018 si dhe pjesa tjetër nga një donacion i Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim. Qëllimi i hapjes së këtij inkubatori është krijimi i një hapësire të përbashkët për fermerët e zonës së Përmetit për të prodhuar produktet tipike me metoda tradicionale dhe certifikuar ato me kërkesat e tregut dhe sigurisë ushqimore, duke i garantuar aksesin në treg edhe fermerëve të vegjël. Ky inkubator ka dy linja prodhimi, një për raki të ndryshme tradicionale të zonës dhe tjetra për tharje, prerje dhe paketim fruta – perime.



(prodhime të ndryshme tradicionale në inkubatorin në Përmet)

Në mbështetje të politikave bujqësore dhe bazuar në ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e qarkut”, institucioni i Prefektit, në mënyrë të vazhdueshme, ka monitoruar situatën në rajon si dhe ka ndjekur zbatimin e objektivat afatmesme të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, nga degët territoriale apo njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim orientimin e fermerëve për të përfituar sa më shumë mbështetjeje financiare. Bazuar në statistikën aktuale qarku Gjirokastrë ka sipërfaqe të mëdha tokash bujqësore. Nga ndarja e tokës janë krijuar ferma private me sipërfaqe të vogël toke, mesatarisht 2 ha për familje dhe kjo e copëzuar në pesë dhe me shumë parcela brenda fermës. Terreni në të cilën ndodhen disa ferma është fushor dhe përshkohet nga lumi i Drinos, përroi i Suhës dhe një sërë kanalesh kullues e vaditës. Përgjithësisht fshatrat janë të vendosura në lartësitë 750-850 m mbi nivelin e detit, e cila përkon me lartësinë mesatare të rajonit. Klima karakterizohet nga pranvera e hershme, vera e thatë dhe vjeshta e dimri mesatarisht të lagësht, të shoqëruara me borë e ngrica në pjesë të ndryshme. Këta faktorë kanë përcaktuar tendencat e reja të zhvillimit të fermave private, të ardhurat e të cilave po dominohen gjithnjë e më qartë nga frutikultura, vreshtaria dhe blegtoria. Përdorimi kryesor i drithrave ka filluar të jetë ushqimi i blegtorisë dhe përdorimi për prodhimin e bukës ka mbetur vetëm në disa fshatra të largët. Bazuar në të dhënat e INSTAT, rajoni i Gjirokastrës renditet në qarkun më nivelet më të ulta të prodhimeve të perimeve në vend. Perimet prodhohen për konsum familjar, me përjashtim të disa fshatrave të cilat prodhojnë edhe për t'i shitur prodhimet në qytetet kryesore.

Gjendja është e ngjashme edhe për kultivimin e patates dhe fasules. Arsyt kryesore lidhen me faktin se shumica e fshatrave nuk kanë dalje në treg për të shitur prodhimet, kostoja e prodhimit është e lartë për shkak të faktorëve klimatikë dhe mungojnë fabrikat e përpunimit të perimeve. Gjithashtu, problem mbetet dhe numri i ulët i fermerëve të pajisur me nipt. Për vitin 2018 nga 23.000 fermerë të rregjistruar vetëm 1300 rezultojnë me nipt. Si pasojë, fermerët pa nipt nuk përfitojnë subvencione

nga shteti edhe pse pothuajse çdo vit fondet në bujqësi dhe subvencionet nga Skemat Kombëtare janë lehtësisht të arritshme për të gjithë ata që duan të investojnë në këtë sektor. Prandaj, është e rëndësishme që fermerët të pajisen më nipt dhe të rregjistrohen për të përfituar nga politikat bujqësore. Përsa i përket sipërfaqeve pyjore dhe kullimore në juridiksion të bashkive të qarkut Gjirokastrë, nga burimet administrative paraqiten këto të dhëna statistikore;

Qarku	Bashkia	Njësia administrative	Sipërfaqe Pyjore(ha)	Sipërfaqe Kullimore(ha)
GJIROKASTËR	GJIROKASTËR	Gjirokastrë	262.75	1354
		Cepo	3568.4	2253
		Picar	3009	4471
		Lazarat	92.75	1191
		Lunxhëri	1064.8	1214
		Antigone	316.6	1031
		Odrie	1096.2	1088
		Totali	9411.3	12602
	LIBOHOVË	Libohovë	333	552.6
		Qendër Libohovë	553.1	1947.1
		Zagorie		88.2
		Totali	886.1	2587.9
	DROPULL	Dr. i Poshtëm	597	3257.8
		Dr. i Sipërm	3237.8	3673.4
		Pogon	6223.9	5963.4
		Totali	10058.7	12894.7
	PËRMET	Çarçovë	3819.7	1834.6
		Petran	3787.1	2176.9
		Piskovë	2376.5	2079.7
		Frashër	620	1016.1
		Totali	10603.3	7107.3
	KËLCYRË	Këlcyrë	1175	2662
		Ballaban	1412	2822
		Dishnicë	2849	2113
		Sukë	1482	1625
		Totali	6918	9165
	TEPELENË	Q.Tepelenë	6051	9282
		Lopës	753	5080
		Kurvelesh	2780	6162

MEMALIAJ	Totali	9584	20524
	Memaliaj		708.1
	Fshat Memaliaj		
	Krahës	3928.1	1038.5
	Qesarat		
	Luftinjë		
	Buz	4686.7	3857.7
	Totali	8614.8	4896.2

Sipërfaqet pyjore e kullosore të parkut kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli" në bashkinë Përmet

Nr.	Njësia administrative	Sipërfaqe pyjore	Sipërfaqe kullosore
1	Çarçovë	1945	609
2	Petran	5897.3	813
3	Piskovë	6748.4	923
4	Frashër	2810.6	2431

Shënim : Brenda këtij parku ndodhen 1706 ha sipërfaqe pyjore private.

Sipërfaqet pyjore e kullosore të "Bredhit të Sotirës", bashkia Dropull


Nr.	Njësia administrative	Sipërfaqe pyjore	Sipërfaqe kullosore
1	Dropull i Sipërm	1600	0

Sipërfaqet pyjore e kullosore të "Bredhit të Kardhiqit", bashkia Gjirokastrë


Nr.	Njësia administrative	Sipërfaqe pyjore	Sipërfaqe kullosore
1	Cepo	1600	200

Sipërfaqet pyjore e kullosore të parkut natyror "Zagori", bashkia Libohovë

Nr.	Njësia administrative	Sipërfaqe pyjore	Sipërfaqe kullosore
1	Libohovë	1244.4	1893
2	Zagori	2218.5	6841
3	Qendër Libohovë	1449.2	699



(grafiku nr. 1 paraqet strukturën e tokës në qarkun Gjirokastrë)



grafiku nr.2 paraqet ndarjen e sipërfaqeve të mbjella në qarkun Gjirokastrë)

Bordi i kullimit Gjirokastrë

Gjatë vitit 2018, sektori i Bordit të Kullimit Gjirokastrë ka realizuar disa investime të cilat synojnë përmirësimin e sistemit kullues dhe konkretisht:

- Mbrojtja nga gërryerja e tokave bujqësore fshati Bodrisht me vlerë 12 milion lekë
- Rehabilitimi i ushqyesit të rezervuarit të Doftisë me vlerë 2 milion lekë
- -Rehabilitimi i sistemit kullues K-1 60.000 m³ me vlerë 4 milion lekë
- -Rehabilitimi i sistemit ujitës 5.000 m³ me vlerë 400.000 lekë

3.7 BLEKTORIA

Blektoria është një nga burimet kryesore e të ardhurave në ekonominë private të familjeve të qarkut Gjirokastrë. Lartësia mbi nivelin e detit mundëson rritjen e kafshëve dhe mbarështimin e tyre. Prodhimet blektorale, vitet e fundit, kanë pasur një rritje të konsiderueshme duke e renditur industrinë

përpunuese të ushqimit, si një nga industritë jetike për ecurinë ekonomike të rajonit.

Përsa i përket numrit të krerëve që rriten dhe mbarështohen në qarkun Gjirokastrë, nga burime administrative paraqiten këto të dhëna statistikore.

Nr.	Bashkia	Emërtimi	Krerë gjithësej
1.	Bashkia Gjirokastrë		147265
		Gjedhë	5523
		Të leshta	77793
		Të dhirta	24162
		Derra	245
		Njëthundrak	1187
		Shpendë	32090
		Bletë (koshere)	6265
2.	Bashkia Dropull		58442
		Gjedhë	1551
		Të leshta	17662
		Të dhirta	6376
		Derra	0
		Njëthundrak	358

	Shpendë	29540
	Bletë (koshere)	2995
3. Bashkia Libohovë		41885
	Gjedhë	1907
	Të leshta	22010
	Të dhirta	6031
	Derra	310
	Njëthundrak	257
	Shpendë	8580
	Bletë (koshere)	2760
4. Bashkia Tepelenë		116920
	Gjedhë	4700
	Të leshta	67100
	Të dhirta	26100
	Derra	50
	Njëthundrak	1470
	Shpendë	15000
	Bletë (koshere)	2500
5. Bashkia Memaliaj		131300
	Gjedhë	3200
	Të leshta	44400
	Të dhirta	21400
	Derra	0
	Njëthundrak	1700
	Shpendë	58000
	Bletë (koshere)	2600
6. Bashkia Përmet		57736
	Gjedhë	1605
	Të leshta	15523
	Të dhirta	21200
	Derra	450
	Njëthundrak	958
	Shpendë	13000
	Bletë (koshere)	5000
7. Bashkia Këlcyrë		64171
	Gjedhë	1181
	Të leshta	27423
	Të dhirta	17380
	Derra	176
	Njëthundrak	711
	Shpendë	15100
	Bletë (koshere)	2200
TOTALI I QARKUT		617719

(tabela paraqet të dhëna statistikore mbi numrin e krerëve që rriten në qarkun Gjirokastrë, për vitin 2018)

Prodhimet blektorale

Bazuar në statistikën e INSTAT-it, qarku Gjirokastrë ka rendimentin më të ulët në nivel vendi përse i përket prodhimit të qumështit të lopës me 1650 kg qumësht për krerë dhe prodhimit të mishit peshë e gjallë me 5.0 %.


Krahasuar me vitin 2017 vihet re një rritje e vogël e prodhimeve blektorale në rang qarku.

a. Prodhimet blektorale

Qarku	Prodhimet blektorale	Viti 2017	Viti 2018
GJIROKASTËR	Lopë	22 ton	24 ton
	Dele	11 ton	11 ton
	Dhi	10 ton	11 ton
	Qumësht/000 ton	43 ton	46 ton
	Vezë	15 mln	16 mln
	Lesh	454 ton	460 ton
	Mjalt	364 ton	368 ton

(tabela paraqet të dhëna statistikore mbi prodhimet blektorale në qark për vitin 2018, krahasuar me vitin 2017)

b. Prodhim mishi peshë e gjallë /ton



3.8 PUNËSIMI


Reformimi në sektorin e punësimit, si një një nga angazhimet më serioze të qeverisë shqiptare kundrejt përmirësimit të mirëqenies qytetare, ka patur impakt pozitiv tek pjesëmarrja në tregun e punës dhe tek punësimi në përgjithësi. Gjithashtu është përmirësuar ndjeshëm efienca dhe targetimi i politikave të punësimit.

Përparimet në reformat e filluara janë thelbësore për të siguruar qëndrueshmëri të rritjes ekonomike në rajon dhe jo vetëm. Ndryshimet në kuadrin rregullativ të arsimit profesional kanë bërë të mundur përmirësimin e cilësisë dhe njohjen e arsimit profesional duke përmirësuar shanset për punësim dhe mobilitete të profesionistëve.

Kjo ka bërë që gjatë vitit 2018 numri i pjesëmarrësve në kurset e shkurtra të trajnimit të rritet me 25% në krahasim me 2017. Të dhënat statistikore nga burimet administrative, tregojnë se papunësia në qarkun Gjirokastrë, fatkeqësisht, mbetet në shifra relativisht të larta. Në përgjithësi rajoni i Gjirokastrës, karakterizohet nga papunësi më e lartë tek femrat se tek meshkujt.

Bazuar në të dhënat e marra nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Gjirokastrë, për vitin 2018 janë paraqitur pranë zyrave të punës 3737 punëkërkuar të papunë. Aplikimi i skemës së re të ndihmës ekonomike solli një rritje rreth 28% të punëkërkuarve që janë drejtuar pranë zyrave të punës. Nëpërmjet programeve të qeverisë për hapjen e vendeve të reja të punës,

mundësia e ndërmjetësimit dhe nxitja e formimit profesional, kanë bërë të mundur që gjatë kësaj periudhe të punësohen një numër i konsiderueshëm punëkërkuar të papunë. Nga zyra rajonale e punës, gjatë këtij viti, janë punësuar rreth 100 pu.pa që i përkasin ish skemës së ndihmës ekonomike. Duke shqyrtuar grupmoshat e ndryshme të të punësuarve në rajon, vëmë re se shumica e të punësuarve janë midis 31-45 vjeç dhe mbi 45 vjeç. Grupmosha 15-30 vjeç e ndjek nga pas. Në përgjithësi, shihet të ketë një ekulibër të përzier të grupmoshës aktualisht të punësuar në të gjitha bashkitë e qarkut.



(Burimi i informacionit; Zyra Rajonale e Punës Gjirokastrë, 2018)

3.9 NDIHMA EKONOMIKE

Skema e Ndhmës Ekonomike është shtylla kryesore e programit të mbrojtjes sociale e cila synon zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë. Reformimi i kësaj skeme solli transparence, efikasitet dhe lehtësim dokumentacioni dhe procedurash për qytetarët që aplikojnë për ndihmë ekonomike. Me aplikimin e sistemit të ri të ndihmës ekonomike në vendin tonë, shumë prej familjeve pretenduese në qarkun Gjirokastrë, nuk u vlerësuan me pikët e

mjaftueshme nga ky sistem dhe duke u krahasuar me vitin 2017 pati një rënie të konsiderueshme të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Duke parë ecurinë e sistemit të ri, gjatë vitit 2018, u vu re ndryshimi në mënyrën e konceptimit dhe qasjes së saj nga individët që bëjnë pjesë në të. Shmangia e abuzivitetit njërëzori favorizoi familjet që me të vërtetë kishin nevojë.

Përsa i përket aplikimeve me sistemin e ri nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social

Gjirokastrë, paraqiten këto të dhëna;

Dhjetor 2018

Nr.	Qarku	Aplikues	Përfitues	Të refuzuar
1	Qarku Gjirokastrë	1104	840	264

Në aplikimet e deritanishme, vihet re një rritje e vogël e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, afërsisht 332 familje, e shprehur në % situata në bashkitë e qarkut paraqitet si më poshtë:

- Bashkitë Gjirokastrë, Libohovë dhe Durrës zënë afërsisht 19% të numrit të

familjeve në skemën e ndihmës ekonomike.

- Bashkitë Tepelenë dhe Memaliaj zënë afërsisht 56 % të numrit të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike.
- Bashkitë Përmet dhe Këlcyrë zënë afërsisht 30 % të numrit të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike.

3.10 SIGURIA DHE RENDI PUBLIK

Duke qenë se krimi i organizuar mbetet një nga plagët e shoqërisë shqiptare, lufta kundër kriminalitetit vazhdon të mbetet një nga prioritetet thelbësore të qeverisë duke materializuar reforma të njëpasnjëshme në minimizimin e këtij fenomeni. Me përgjegjësinë që i jep ligji nr.107/2016, “Për Prefektin e qarkut” neni 12, Prefekti i qarkut ka bashkërenduar veprimtarinë dhe ka siguruar mbështetjen e ndërsjellë të organeve të Policisë së Shtetit, të institucioneve shtetërore në nivel vendor dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore, për marrjen e masave për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike në nivel qarku.

Bazuar në burimet administrative, gjatë vitit 2018, krahasuar me vitin e kaluar, kriminaliteti është ulur në 125 vepra penale më pak, (nga 972 vepra penale të evidentuara gjatë vitit 2017 në vitin 2018 janë evidentuar 847) si dhe janë evidentuar

847 vepra penale, nga të cilat janë zbuluar 744 prej tyre, ose 87.8%.

Në fushën e narkotikëve janë evidentuar 67 vepra penale, zbuluar 58 ose 86.5%. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ku u evidentuan 99 vepra penale, konstatohet një reduktim i kriminalitetit me 32 vepra penale më pak si dhe reduktim të sasive të lëndëve narkotike të sekuestruara me rreth 4 herë më pak.

Në fushën e trafikeve të paligjshme janë evidentuar 21 vepra penale, zbuluar 21 ose 100%. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kur u evidentuan 13 vepra penale, konstatohet një rritje e forcës evidentuese e goditëse me 8 raste më shumë. Në fushën e korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimeve eko-financiare janë evidentuar 101 vepra penale, zbuluar 96 ose 95%. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kur u evidentuan 109 vepra penale, konstatohet një reduktim i kriminalitetit me 8 raste më pak.

3.11 EMERGJENCAT CIVILE

Bazuar në ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, ligjin nr. 8576/2001 “Për Emergjencat Civile”, i ndryshuar, dhe VKM-se Nr. 655/2003 “Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit kombëtar të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile”, në institucionin e Prefektit është ngritur dhe ka funksionuar Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në nivel qarku.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, gjatë vitit 2018 ka ndjekur dhe monitoruar të gjitha situatat emergjente të krijuara në qarkun tonë si rezultat i kushteve të vështira atmosferike në stinën e dimrit apo të verës. Janë marrë masat për të bashkërenduar punën mes institucioneve qendrore në nivel vendor dhe organeve të vetëqeverisjes vendore për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj.

Në të gjitha takimet e zhvilluara me komisionin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave është kërkuar përgjegjësi dhe angazhim maksimal për përgatitjen e planeve të emergjencave civile në çdo bashki dhe marrje masash për përballimin e situatave emergjente. Vëmendje i është kushtuar ndjekjes në terren të dinamikës së krijuar për shkak të emergjencave si dhe kordinimit dhe mbështetjes së strukturave, anëtare të KECQ, për normalizimin e situatave të krijuara nga rreshjet e shiut dhe të dëborës, si dhe të emergjencave verore. Është konstatuar se situata e emergjencave civile në vitin 2018 është menaxhuar dhe monitoruar me kujdes, duke e konsideruar atë të suksesshme si pasojë e koordinimit të këtyre strukturave dhe mbikqyrjes maksimale të ndjekura sistematikisht nga Institucioni i Prefektit.

3.12 MONITORIMI I FONDEVE TË TRANSFERUARA NGA BUXHETI PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

Në përmbushje të misionit dhe përgjegjësi, mbështetur në Ligjin Nr.107/2016 “Për Prefektin e qarkut”, Vendimet e KM dhe Udhëzimeve në zbatim të tyre, është bashkërenduar puna me njësitë e vetëqeverisjes vendore për ushtrimin nga ana e tyre, të funksioneve të transferuara nga institucionet qendrore, duke mbikqyrur dhe monitoruar fondet e transferuara (transferten specifike). Për vitin 2018, totali i transfertave që qeveria shqiptare ka akorduar për qarkun Gjirokastrë ishte 1.2 miliard lekë gati 16 % me shumë nga viti 2017, dhe konkretisht për:

Rrjetin e rrugëve rurale

Gjatë vitit 2018 fondet nga transfertat e pakushtëzuar për fonde specifike, për mirëmbajtjen e rrugëve rurale, janë rritur me 429 mijë lekë, ose 10 % krahasuar me vitin e kaluar. Fondi specifik për vitin 2018 ishte rreth 43 milion lekë.

Pyjet dhe kullotat publike

Gjatë vitit fondet nga transfertat specifike, për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave, janë rritur me 2 milion lekë, ose 38 % krahasuar me vitin e kaluar. Për vitin 2018 u

planifikuan të kryen shpenzime me vlerë 25 milion lekë.

Sistemin e ujitjes dhe kullimit

Gjatë vitit fondet nga transferta specifike, për kryerjen e shërbimit në sistemin e ujitjes dhe kullimit, janë rritur me 4.551 lekë, ose 0.9% , krahasuar me vitin e kaluar. Ky fond për vitin 2018 ishte në vlerë 42 milion lekë.

Arsimi parashkollor, arsimi parauniversitar, konviktet e arsimit parauniversitar

Gjatë vitit fondet nga transferta specifike, për sistemin e arsimit (bazë, të mesëm dhe konviktet e arsimit parauniversitar), ishte 265 milion lekë, krahasuar me vitin e kaluar është rritur me rreth 15 % më shumë.

3.13 ZHVILLIMI RAJONAL

Në kuadër të zhvillimit ekonomik të rajonit, Qeveria Shqiptare gjatë vitit 2018 ka akorduar fonde për realizimin e një sërë investimesh të cilat të cilat kanë pasur një impakt të rëndësishëm në jetën sociale dhe ekonomike të banorëve.


Konkretisht, me fonde nga buxheti i shtetit apo donatorë të tjerë, janë prokuruar dhe janë në proces një sërë projektsh të cilat konsistojnë në: përmirësim të infrastrukturës rrugore, rehabilitim urban, shëndetësi, arsim, turizëm, etj.


Realizimi i investimeve në bashkitë e qarkut Gjirokastrë viti 2018

Vlera e prokurimit: 1.5 miliard lekë

Realizimi : rreth 1.1 miliard lekë

Realizimi në %: rreth 79 %





(bazuar në evidencat e dërguara nga NJVQV për periudhën janar-dhjetor 2018)

Disa nga investimet më kryesore vlen të përmendim;

RIKUALIFIKIM URBAN

RESTAURIMI I PAZARIT TË GJIROKASTRËS, MBI 5000 M2.

Investim i Qeverisë Shqiptare dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan në kujdesin e FSHZH.(faza I)

Vlera e projektit: rreth 3.5 milion dollarë.

Përfitojnë rreth 52 mijë banorë



Pamje para investimit



Pamje pas investimit

RIKUALIFIKIM URBAN I QENDRËS SË QYTETIT PËRMET

Investim i Qeverisë Shqiptare
Vlera e projektit: 102 milion lekë
Përfitues rreth 18 mijë banorë



Pamje para investimit




Pamje pas investimit

RIKUALIFIKIM URBAN I QENDRËS SË QYTETIT LIBOHOVË

Investim i Qeverisë Shqiptarë nëpërmjet FZHR (Fondi për Zhvillimin e Rajoneve)
Vlera e projektit: 139 milion lekë
Përfitojnë rreth 7 mijë banorë



Pamje, para investimit



Pamje, pas investimit

RIKUALIFIKIM URBAN I QENDRËS SË QYTETIT TEPELENË

Investim i Qeverisë Shqiptare nëpërmjet FZHR

Vlera e projektit: rreth 150 milion lekë

Përfitojnë 15 mijë banorë



Pamje, para investimit



Pamje, pas investimit

RIJETËSIMI I PEDONALEVE DHE HAPËSIRAVE REKREATIVE NË SHESHIN QENDËR, BASHKIA KËLCYRË

Investim i Qeverisë Shqiptare nëpërmjet FZHR

Vlera e projektit: 148 milion lekë

Përfitojnë rreth 12 mijë banorë



Pamje, para investimit



Pamje, pas investimit

ANSAMBLI ARKITEKTONIK "SHESHI MINATORI", BASHKIA MEMALIAJ

Rikonstruksion i Ansamblit Arkitektonik "Sheshi Minatori", bashkia Memaliaj

Investim i Qeverisë Shqiptare nëpërmjet FZHR

Vlera e projektit: 98 milion lekë.

Përfitojnë rreth 20 mijë banorë



pamje para investimit



pamje pas investimit

RIKONSTRUKSION I RRUGËS "AGO ÇELI", RRUGËS SË RE DHE PALESTRA E LGJ."15 SHTATORI:", BASHKIA TEPELENË

Investim i Qeverisë Shqiptare nëpërmjet FZHR

Vlera e projektit: 146 milion lekë

Rikonstruksioni i palestrës së lgj."15 Shtatori"



pamje para investimit



pamje pas investimi

➤ INFRASTRUKTURA RRUGORE

- Ndërtim i rrjetit rrugor “Unaza Pogon”, bashkia Dropull

Investim i FZHR

- Vlera e prokurimit: 138 milion lekë




- Aksi Gjirokastrë-Lazarat

Rehabilitimi i plotë i aksit Gjirokastrë-Lazarat

me gjatësi 3.5 km.

Vlera e investimit rreth 1 milion euro dhe kryhet në kuadër të projektit të përbashkët me Bankën Botërore për mirëmbajtjen e akseve rrugore kombëtare.



RESTAURIM I MONUMENTEVE TË KULTURËS

Gjatë vitit 2018 në qarkun e Gjirokastrës, vëmendje është treguar për mirëmbajtjen dhe restaurimin e monumenteve të kulturës, në shërbim të zhvillimit të turizmit. Disa nga restaurimet kryesore janë:



Ura e Katiut, Përmet



Ura e Nivanit, Zagorie



Ura e Kordhocës, Gjirokastrë



Kisha e Shën Marisë në Labovën e Kryqit

Programet kombëtare “Rrugët e Besimit” dhe “Rrugët e Kujtesës” do të ofrojnë përgjatë vitit të ardhshëm shumë itinerare të reja turistike, ku në fokus do të jetë gjithmonë e më shumë turizmi kulturor.

PROJEKTE NË VAZHDIM

REHABILITIM I INFRASTRUKTURËS DHE RESTAURIM I KALLDRËMEVE NË PAZARIN E GJIROKASTRËS.

Pas përfundimit të fazës së parë ku është ndërhyrë në 10 blloqe banimi në Qafën e Pazarit, ka nisur faza e dytë e punimeve në kuadër të programit "Për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin"

- Vlera e punimeve: 137 milion lekë
- Afati i realizimit të projektit: 12 muaj
- Sipërfaqja që do të trajtohet është 5,290 m² dhe ndërhyrja do të prekë të gjitha rrjetet infrastrukturore nëntokësore.



BY PASS-I TEPELENË

Fondi limit nga Buxheti i Shtetit : 2.8 miliard lekë

Gjatësia e segmentit: 2.3 km 2 korsi me 3.7 m

Afati i realizimit të projektit: 24 muaj

Projekti përfshin lidhjen e dy segmenteve rrugore:

- Levan Tepelenë në hyrje
- Tepelenë – Gjirokastrë – Kakavie në dalje, si pjesë e korridorit Veri-Jug.



pamje nga projekti

AKSI RRUGOR KARDHIQ-DELVINË

Gjatësia totale: 34 km

Rrugë të ndërtuara: 16 km

Rrugë për ndërtim: 16 km

Numri i loteve: 8

Lote të ndërtuara: 3

Lotë për ndërtim 2018: 3

Lotë për ndërtim 2019: 2



Vlera për ndërtimin e dy segmenteve: 41 milion dollarë

Realizimi i këtij projekti:

- Zhvillon turizmin, ekonominë dhe punësimin
- Shkurton distancën Tiranë-Sarandë
- Kthen Sarandën dhe Gjirokastrën në një ofertë të përbashkët turistike
- Afron Delvinën me Tiranën dhe Gjirokastrën
- Zgjeron potencialin turistik dhe ekonomik të gjithë zonës.



RIKONSTRUKSIONI I QENDRAVE SHËNDETËSORE

Gjatë vitit 2018 me investime nga buxheti i shtetit, u rehabilituan disa qendra shëndetësore, konkretisht;

- Gjirokastrë: qendra shëndetësore në lagjen “Dunavat”, “Palorto”, “11 Janari”, “18 Shtatori”, “Varosh”, etj.
- Njësia administrative Cepo: qendra shëndetësore Kardhiq
- Njësia administrative Lunxhëri: qendra shëndetësore Shën Todhër:
- Tepelenë: qendra shëndetësore Krahëz
- Përmet: qendra shëndetësore Petran.



Qendra shëndetësore, lagja "Varosh" Gjirokastrë



Qendra shëndetësore, Valare

RIKONSTRUKSIONE NË UJËSJELLËSA E KANALIZIME

Ka përfunduar faza e parë e sistemit të depove dhe pompave, një investim i qeverisë shqiptare me KFË Gjermane dhe shumë shpejt pritet të fillojë edhe faza e dytë për bashkinë e Gjirokastrës. Me përfundimin e fazës së dytë të investimit i gjithë qyteti i Gjirokastrës do të ketë furnizim me ujë për 24 orë. Investime po kryen dhe në rrjetin e shpërndarjes së ujësjellësit në qytetin e Tepelenës dhe në Memaliaj. Po vazhdojnë punimet për rehabilitim në bashkinë Përmet, Këlcyrë dhe Dropull.



Rikonstruksion ujësjellësi në Memaliaj



Rikonstruksion ujësjellësi në Përmet

RIKONSTRUKSIONI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Rikonstruksion i shkollës së mesme “Asim Zeneli” + sistem i jashtëm (loti I + loti II)

- Investim i Qeverisë Shqiptare (FZHR) dhe Bashkisë Gjirokastrë
- Vlera e plotë e projektit : 83 milion lekë



pamje para restaurimit



pamje nga projekti

Rikonstruksion i shkollës së mesme "Sami Frashëri", Përmet

- Investim i Qeverisë Shqiptare (FZHR) dhe Bashkisë Përmet
- Vlera e plotë e projektit : 85 milion lekë



shkolla e mesme "Sami Frashëri"

Rikonstruksioni shkollës së mesme të përgjithshme , bashkia Këlcyrë

- Investim i Qeverisë Shqiptare (FZHR) dhe Bashkisë Këlcyrë
- Vlera e plotë e projektit : 56 milion lekë



*shkolla e mesme e përgjithshme,
Këlcyrë*

Rikonstruksion i shkollës “Avni Rustemi”, bashkia Libohovë

- Investim i Qeverisë Shqiptare (FZHR) dhe Bashkisë Libohovë
- Vlera e plotë e projektit : 65 milion lekë



shkolla "Avni Rustemi"

3.14 VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Prefekti i Qarkut gjatë vitit ka vazhduar konsultimin dhe bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta, duke kryer edhe verifikimin e ligjshmërisë së akteve të nxjerra prej tyre.

Për vitin 2018 nga këshilli i qarkut dhe shtatë bashkitë që përfshin qarku i Gjirokastrës janë paraqitur për verifikim të ligjshmërisë pranë Prefektit të qarkut Gjirokastrë gjithsej 637 akte nga të cilat janë konfirmuar si të bazuara në ligj 555 (rreth 87%) dhe janë kthyer të pakonfirmuar 82 (rreth 13%).


Akte të organeve të vetëqeverisjes vendore



Nga evidenca e akteve rezulton se njësitë me numrin më të vogël të vendimeve të pakonfirmuara janë këshilli i qarkut, me asnjë vendim të pakonfirmuar, bashkia Gjirokastrë dhe bashkia Memaliaj me 4% të akteve të pakonfirmuara. Njësitë me numrin më të madh të vendimeve të pakonfirmuara është bashkia Përmet me 22 % dhe bashkia Këlcyrë me 26% të akteve të pakonfirmuara. Krahasimisht me vitin 2017 vihet re një numër më i madh aktesh të paraqitura nga

ana e njësive të vetëqeverisjes vendore, ndërsa për sa i përket nivelit të vendimeve të pabazuara në ligj ai është pothuaj i njëjtë (me një ndryshim të vogël 1%). Konkretisht në vitin 2017 nga totali i akteve të paraqitur për konfirmim nuk janë konfirmuar 12% e akteve, ndërsa në vitin 2018 nuk kanë marrë konfirmimin e Prefektit afërsisht 13% e akteve të paraqitura.

**Numri i akteve të pakonfirmuara
viti 2017-2018**



3.15 PROGRAMI KOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN RURAL – “100 FSHATRAT”

I. Programi “100 Fshatrat”

Qëllimi i Programit

Programi i Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR) – Programi i 100 fshatrave synon të koordinojë ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave.

Objektivat e Programit

PIZHR do të programojë ndërhyrjet me investime të integruara në zonat e përcaktuara (100 fshatra), nëpërmjet 3 objektivave si më poshtë:

a) Përmirësimi i infrastrukturës publike (mbështetja për infrastrukturë rrugore, rivitalizime hapësirash publike/urbane, infrastrukturë komunitare, shërbime publike, infrastruktura mjedisore, turistike, monumente të trashëgimisë kulturore, qendra multifunksionale komunitare, pejsazhi mjedisor etj.)

b) Zhvillimi ekonomik nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike (përmirësimi i potencialit turistik në hapësirat rurale, agroturizëm dhe turizëm rural, investime në përmirësimin e shërbimeve tregtare, investime në prodhimin e produkteve tradicionale dhe shërbime të tjera ekonomiko-financiare etj. Mbështetja për inkubatorë të produkteve rurale tradicionale, promovim dhe marketim të zonave rurale, shërbime transporti, panairë, festa lokale etj.)

c) Zhvillimi i kapitalit social dhe njerëzor, (mbështetje për krijimin e rrjeteve rurale, grupeve lokale të veprimit si dhe shoqërië civile në zonat rurale, trajnim profesional për të rinjtë dhe gratë, mbështetje të trashëgimisë kulturore, mbështetje për promovimin e traditave dhe jetesës në fshat, etj.)

Kohëzgjatja e programit

“Programi i Integruar për Zhvillimin Rural– Programi i 100 fshatrave”, do të zbatohet në periudhën 2018-2020.

Zbatimi

Projektet e financuara në kuadrin e programit të 100 fshatrave do të zbatohen kryesisht nga bashkitë si dhe agjenci të tjera publike (Agjencitë e Zhvillimit Rajonal 1,2,3 dhe 4, Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, Agjencia Kombëtare e Turizmit, FSHZH, MADA, etj.).

Programi do të mbështesë edhe projekte të propozuara nga organizatat e shoqërisë civile (OJF), individë, fermerë, persona juridik etj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në Programin e Integruar për Zhvillimin Rural – Programi i 100 fshatrave, janë përzgjedhur 13 fshatra të qarkut Gjirokastrë, me potencial të lartë të zhvillimit ekonomiko-social, të trashëgimisë kulturore, agroturizmit, turizmit rural dhe mjedisit. Pas rivitalizimit të qendrave kryesore të qyteteve, rivitalizimi i fshatrave e jetës së

tyre është një sfidë e re e qeverisë shqiptare. Ky program që të entusiazmon me synimet që shpalos synon përmirësimet infrastrukturore mjedisore turistike, ringjalljen e turizmit e agroturizmit për përmirësimin e shërbimeve tregëtare me produktet tradicionale.

a. 13 fshatrat e përzgjedhur

Qarku	Bashkia	Fshati / Njësia administrative
GJIROKASTËR	GJIROKASTËR	Dhoksat
		Zhulat
		Picar
		Lazarat
		NjA. Antigone
	LIBOHOVË	Labovë e Sipërme
		Nepravishtë
	DROPULL	Sotirë
	PËRMET	Leusa
		Kosinë
	KËLCYRË	Malëshovë
	TEPELENË	Nivicë
		Peshtan
	MEMALIAJ	Kalivaç

3.16 ROLI I INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT GJIROKASTËR NË ZHVILLIMIN E RAJONIT

Në kuadër të projekteve të Delegacionit European dhe Programit Interreg IPA Greece-Albania 2014-2020, (INTERREG, ADRION, PANORAMED, MED, BALLKANMED) të cilat janë projekte me rimbursim shpenzimesh dhe vlerësim performance, institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë ka marrë pjesë aktive në thirrjet e këtij programi dhe ka realizuar projekte në bashkëpunim të ngushtë me shoqata të ndryshme që kanë në fokus zhvillimin ndërkufitar të turizmit dhe institucioneve pjesëmarrëse në këto projekte në cilësinë e partnerit.

Në këtë kuadër së fundmi, institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë ka realizuar

Projektin "Krijimi i rrjetit dhe promovimi i kështjellave" shkurt Net Castle, i cili është zbatuar në bashkëpunim me Qendrën UET nga pala shqiptare dhe Rajonin e Ishujve Jonian nga pala greke. Për herë të parë kështjellat dhe kalatë e qarkut Gjirokastrë jo vetëm janë dixhitalizuar dhe hedhur në sistem 3D, por mbi të gjitha do të kenë një promovim të jashtëzakonshëm. Me pak fjalë, çdo i interesuar, në çdo anë të globit mjafton të klikojë në websiten e projektit (netcastle-webgis.eu) dhe aty mund të shohë në sistemin 3D dhe të vizitojë virtualisht 12 kështjellat e qarkut Gjirokastrë.

Aktualisht, janë duke u realizuar dhe disa projektet si;

Projekti THEMA

Projekti "THEMA" ofron zgjidhje për rritjen dhe zhvillimin e zonave ndërkufitare duke përdorur teknologjitë e reja. Thema krijon inovacione në tri nivele:

1- Teknologjik, duke përfshirë një formë të re të sensorëve të vendndodhjes me bazë bluetooth dhe një mekanizëm inovativ të shpërblimit në Shqipëri.

2- Përmbytësor: duke shfrytëzuar dhe pasuruar rrugët ekzistuese, duke u ofruar qasje të hapur të përmbytjes prej agjentëve turistikë dhe operatorëve turistikë.

3- Në nivel social, duke promovuar socializimin dhe fuqizimin e përdoruesve. Përdoruesit përfundimtarë të THEMA janë turistë që mund të përfitojnë nga zgjidhja në mënyra të shumta, në përfitues përfshihen gjithashtu operatorët turistikë, agjentët

turistikë si dhe profesionistët e turizmit në përgjithësi. Së fundi autoritetet vendore (Bashkia dhe Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë) do të përfitojnë nga rritja e turizmit në zonën e tyre.

Objekti i përgjithshëm është i dyfishtë:

- të përmirësojë përvojën e përgjithshme të përdoruesve që vizitojnë si turistë rajonin Ndërkufitar.

- të rrisë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të rajonit përmes teknologjisë bashkëkohore dhe turizmit tematik, përmes rritjes së interesit të audiencës dhe ofrimin e shërbimeve të avancuara dhe cilësore për të gjithë.

Hapat për realizimin e projektit THEMA:

- Hartimi dhe hedhja në hartë e rrugëve që do të jenë pjesë e tre paketave tematike. Sensorët e zgjuar të vendndodhjes, me bazë Bluetooth, do të instalohen në të gjithë rrugët për navigim dhe shpërndarje në telefonin celular të përdoruesit.

-Zhvillimi i aplikacionit për celular në Android dhe IOS.

-Zhvillimi i funksioneve shtesë të integruara në aplikacionin celular për socializim dhe bashkëpunim midis përdoruesve.

-Përcaktimi i paketave tematike turistike.

Profesionistët mund të shfrytëzojnë paketat tematike dhe rrugët e ofruara nga projekti THEMA si dhe komuniteti dinamik dhe përdorues i projekti THEMA me qëllim të promovimit të biznesit të tyre duke rritur konkurrueshmërinë e tyre në tregun e kërkuar të sektorit të turizmit.

Projekti CULTURAL LANDS

“Cultural Lands” është projekti që mundëson promovimin dhe ruajtjen e aseteve kulturore të zonës ndërkufitare (ZN) jo homogjene që lidhen nga një rrugë për të lulëzuar fushën e zhvillimit të turizmit. Gjithashtu, projekti mishëron krijimin e një rrjeti bashkëpunimi në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm vendor dhe rajonal në fushën e ruajtjes dhe promovimit të pasurive të ngjashme kulturore, si parakusht për zhvillimin e turizmit kulturor. Bashkëpunimi i zonave ndërkufitare (ZN-re) demonstron përmes zhvillimit të një monopati tematik turistik e kulturor të ZN, në termat e zhvillimit të një shtegu të çertifikuar ndërkufitar të turizmit. Nyjet e kësaj rruge do të jenë kryesisht ndërtesat historike me karakteristika të veçanta arkitekturore dhe kulturore, të lidhura fort me figurat historike, me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së zonës ndërkufitare si destinacion turistik. Kështu

do të krijohet një rrjet bashkëpunimi që mund të zgjasë dhe shumëfishojë efektin e saj në zonën ndërkufitare / Shqipëri-Greqi.

Projekti POLYPHONIA

Projekti “POLIFONIA” fokusohet në ruajtjen e trashëgimisë kulturore të përbashkët e cila është e rëndësishme për të nxitur identitetin e përbashkët kulturor të zonës ndërkufitare, ndërkohë që përdorimi i saj mund të kontribuojë në rritjen e zhvillimit ekonomik. Një tipar kulturor bazë i zonës ndërkufitare është kënga polifonike. Meloditë e këngës polifonike janë ndër të paktat që kanë ruajtur shkallën pentatonike animitonike (një shkallë e përbërë nga pesë tone pa semitone), në repertorin botëror të polifonisë popullore.

Ky program identifikon Trashëgiminë Kulturore si bazën e një bashkëpunimi ndërkufitar.

Objektivat:

- Ruajtja dhe zhvillimi i një tradite muzikore që tenton drejt zhdukjes, si një element integral i Zonës së Ndërhyrjes.

-Promovimi dhe vlerësimi i këngës polifonike nëpërmjet zhvillimit të karakteristikave historike, muzikore dhe kulturore, në fushën e turizmit tematik.

-Regjistrimi dhe klasifikimi i të gjitha këngëve polifonike dhe traditave që lidhen me to në Zonën e Ndërhyrjes.

-Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar në fushat e artit, kulturës dhe turizmit duke theksuar si muzikën polifonike ashtu edhe turizmin.

-Rritja e numrit të vizitorëve në Zonën e Ndërhyrjes.

-Përmirësimi i atraktivitetit të Zonave të Ndërhyrjes, zhvillimi i mekanizmave të TIK-ut dhe brandimi i përbashkët POLIFONIA, për mbështetje të strukturuar të zhvillimit të turizmit.

-Trajnimi, ndarja e njohurive dhe shkëmbimi i përvojave të profesionistëve dhe autoriteteve/ organizmave (në lidhje me traditën muzikore, ruajtjen e saj dhe turizmin) në nivel lokal dhe ndërkufitar.

Si përfundim pjesëmarrja e Institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë në këto

projekte do të ndikojë si në rritjen e bashkëpunimit ndërkufitar ashtu edhe në pasurimin e elementëve turistik për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në qarkut tonë.

Buletin Statistikor
Qarku Gjirokastrë
Viti 2018

Hartuar nga: Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore
dhe Funksioneve të Deleguara

Përpunimi i informacionit: Arjeta Paçeli
Specialiste e Koordinim Zhvillimit në Sektorin e Monitorimit të
Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara

INSTITUCIONI I PREFEKTIT TË QARKUT GJIROKASTËR
Sheshi “Çerçiz Topulli”, Gjirokastrë/Shqipëri
Tel: ++355 84 26 3435
Fax: ++ 355 84 26 3434
Email: Prefekti.Gjirokastrë@mb.gov.al

Gjirokastrë, janar 2019